

ISBN 978-608-4648-08-6  
ISBN 978-608-65634-2-4  
ISBN 978-608-4586-38-8



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



## **NXITJE E EFIKASITETIT ENERGJETIK: SI MUND TË NDIHMOJNË KOMUNITETET LOKALE?**



**Public Dialogue**  
on the Sustainable Use of  
Energy in South-East Europe

**Shkup, Dhjetor 2013**



**NXITJE E EFIKASITETIT  
ENERGJETIK:  
SI MUND TË NDIHMOJNË  
KOMUNITETET LOKALE?**

**Shkup, Dhjetor 2013**

## I M P R E S S U M

**Titulli:**

Nxitje e efikasitetit energjetik:  
Si mund të ndihmojnë komunitetet lokale?

**Botuesit:**

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë  
Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar  
Qendra për hulumtime dhe krijimin e politikave

**Autorë:**

Zlatko Simonovski  
prof. D-r Natasha Markovska  
Radovan Nikcheviç

**Lekturë në gjuhën shqipe:**

Vjollcë Berisha

**Përkthyer nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:**

Slave Çorbev

**Shtypi:**

©Print Mark

**Tirazhi:**

50 kopje

**Publikimi mundet falas të zbritet:**

<http://www.kas.de/mazedonien/en/publications/>  
[http://www.crpm.org.mk/?page\\_id=695](http://www.crpm.org.mk/?page_id=695)  
<http://www.giz.de/>

**Vërejtje:**

**Qëndrimet e shprehura në publikim nuk janë qëndrime të  
Fondacionit Konrad Adenauer dhe Shoqërisë Gjermane për  
Bashkëpunim Ndërkombëtar, por janë qëndrimet të autorit.**

## Lista e shkurtimeve

|                                                             |
|-------------------------------------------------------------|
| Bashkimi evropian – BE                                      |
| Komisioni evropian – KE                                     |
| Parlamenti evropian – PE                                    |
| Shoqëria energjetike – ShE                                  |
| Republika e Maqedonisë – RM                                 |
| Plani aksionar për efikasitet energjetik – PAEE             |
| Mekanizëm për zhvillim të pastër – MZHP                     |
| Mbrojtje e integruar dhe kontrollë e ndotjes – MIKN         |
| Partneritet publik-privat – PPP                             |
| Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar – ShGjBN     |
| Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave – QHKP         |
| Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë – KAS |
| Sistem për menaxhim me energjinë – SME                      |
| Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes locale të             |
| Rëpublikës së Maqedonisë –BNjVL                             |

## Përmbajtja:

|                                                                                                  |           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1 Efikasiteti energjetik në Bashkimin Evropian</b>                                            | <b>7</b>  |
| 1.1 Sfidat dhe qasja strategjike                                                                 | 7         |
| 1.2 Korniza ligjore e BE-së                                                                      | 12        |
| 1.3 Ndikimi ndaj vendeve jashtë BE-së                                                            | 20        |
| 1.4 Dispozita me ndikim të rëndësishëm në nivel lokal                                            | 21        |
| <b>2 Efikasiteti energjetik në Maqedoni</b>                                                      | <b>25</b> |
| 2.1 Thelbi i strategjisë                                                                         | 25        |
| 2.2 Aktivitetet e tjera                                                                          | 30        |
| 2.3 Mekanizmatfinanciare në dispozicion                                                          | 32        |
| <b>3 Pikëpamjet dhe qëndrimet e komunave maqedonase, organizatave joqeveritare dhe kompanive</b> | <b>34</b> |
| 3.1 Projekti „Dialogu publik për përdorim të qëndrueshëm të energjisë në Evropën Juglindore”     | 34        |
| 3.2 Debatet sipas rajoneve                                                                       | 37        |
| 3.2.1 Rajoni i Shkupit                                                                           | 37        |
| 3.2.2 Rajoni jugperëndimor                                                                       | 39        |
| 3.2.3 Rajoni lindor                                                                              | 40        |
| 3.2.4 Rajoni juglindor                                                                           | 41        |
| 3.2.5 Rajoni i Pellagonisë                                                                       | 42        |
| 3.2.6 Rajoni i Vardarit                                                                          | 44        |
| 3.2.7 Rajoni i Pollogut                                                                          | 45        |
| 3.2.8 Rajoni verilindor                                                                          | 47        |
| 3.3 Tabela e problemeve dhe e zgjidhjeve                                                         | 49        |
| <b>4 Rekomandimet përfundimtare</b>                                                              | <b>53</b> |

## **1 Efikasiteti energjetik në Bashkimin Evropian**

### **1.1 Sfidat dhe qasja strategjike**

I ballafaquar me sfida të mëdha, sidomos në dy dekadat e fundit në fushën e furnizimit dhe konsumit të energjisë, Bashkimi Evropian u detyrua të ndërmarrë një sërë aktiviteteve dhe masash në mënyrë që ta ruajë zhvillimin e vet. Domethënë, tashmë në fund të viteve '90 të shekullit XX, nëpërmjet një varg studimesh, hulumtimesh statistikore, shkencore dhe hulumtimesh të tjera, u theksuan sfidat e reja që lidhen me energjinë, të cilat u paraqitën si rezultat i varësisë nga importet dhe konsumi i rritur. Në atë kohë, Bashkimi ishte në gjendje të kënaqte vetëm 50% të nevojave energjetike të burimeve të veta. Duke pasur parasysh rritjen e shpejtë të kërkesës finale të energjisë, vlerësimet statistikore treguan se importet e energjisë (që ishin 6% të këmbimit të përgjithshëm tregtar të BE-së) do të rriten deri më 70% deri në vitin 2030, kurse varësia e tillë energjetike do të sillte rreziqe ekonomike, sociale, natyrore dhe gjeopolitike edhe për BE-në. Për më tepër, konsumi i vazhdueshëm i energjisë ndikon edhe në ndotjen e mjedisit jetësor, ngrohjen globale, rritjen e emisioneve të gazrave të qelqit, pasigurinë e furnizimit, uljen e konkurrencës së BE-së etj.


Duke i pasur parasysh të gjitha këto, BE-ja u detyrua të zhvillojë strategji, plane aksionare dhe shumë mjete të tjera politike, në mënyrë që të vërë nën kontroll rritjen e shpejtë të konsumit të energjisë. Në fazën e hershme të betejës kundër shfrytëzimit joracional të energjisë, u identifikua një potencial për të kursyer mbi 20% deri në vitin 2020. Pamundësia e shfrytëzimit të energjisë në mënyrë efikase, do t'i kushtonte Bashkimit Evropian mbi 100 miliardë euro në vit deri në vitin 2020. Megjithatë, për ta arritur këtë qëllim ambicioz ishte i domosdoshëm një aksion i harmonizuar nëpërmjet planifikimit strategjik të ndjekur me mjete politike në të gjitha nivele qeveritare dhe shoqërore.

Njëkohësisht, me përgatitjen e kornizës ligjore, Bashkimi Evropian zhvillon edhe një kornizë gjithpërfshirëse strategjike që përcakton kufizimet dhe sfidat e rëndësishme për vetë BE-në. Të dyja qasjet, si ajo strategjike ashtu edhe ajo ligjore, shërbejnë për t'u arritur potencialet dhe qëllimet që tashmë janë vlerësuar dhe përcaktuar. Përderisa korniza ligjore i përcakton obligimet, rregullat, objektivat dhe kodet e obligueshme, korniza strategjike i identifikon pengesat kryesore që pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe e rrezikojnë rritjen ekonomike.


Pastaj, strategjitë përpiqen të gjejnë zgjidhje, të rekomandojnë drejtime dhe të përcaktojnë qëllime konkrete duke ofruar njëkohësisht masat për realizimin e tyre. Korniza strategjike e BE-së u zhvillua sidomos në dekadën e fundit, me ndryshime dhe drejtime të rëndësishme të veprimit. Disa nga këto dokumente të rëndësishme strategjike, të cilat në përgjithësi i japin formë strategjisë së BE-së në fushën e efikasitetit energjetik, ia vlejnë të përmenden dhe të prezantohen shkurtimisht në këtë analizë të politikave.

Një nga dokumentet e para të rëndësishme, që hapi rrugën për zhvillimin e politikave të efikasitetit energjetik ishte "**Libri i Gjelbër - Siguria në furnizimin me energji**", i miratuar nga Komisioni Evropian më 29 nëntor 2010 (COM (2000) 769).

Ky dokument, në atë kohë, ka identifikuar problemet kryesore që lidhen me furnizimin e energjisë. Në fillim, tregon rritjen e vazhdueshme të nevojës së energjisë për Evropën në të ardhmen dhe rreziqet e saj. Thekson se importet ekzistuese të energjensëve nga 50% (që janë aktualisht) në 30 vitet e ardhshme mund të rriten deri më 70%. Duke pasur parasysh se harxhimet për to janë nën ndikimin e vazhdueshëm të ndryshimeve në tregjet ndërkombëtare, kurse çmimi i naftës së papërpunuar është trefishuar që nga marsi i vitit 1999, ishte një arsye e mjaftueshme për një luftë gjithpërfshirëse kundër skenarit të pritur. Në këtë dokument, një vëmendje e veçantë u kushtohet pyetjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit për shkak të rreziqeve që dalin nga prodhimi, transmetimi dhe konsumi i energjisë, që fitohen nga lëndët djegëse fosile. Shpërndarja e pavolitshme e energjisë në vitin 2000 (Pasqyra 1) dhe pjesëmarrja më e keqe e lëndëve djegëse fosile që është paraparë për prodhimin e energjisë deri në vitin për 2030 (Pasqyra 2) e pozicionojnë temën e mbrojtjes së mjedisit në një vend qendror në këtë dokument.



Pasqyra 1. Pjesëmarrja e burimeve të energjisë në BE në vitin 2000



Pasqyra 2. Pjesëmarrja e paraparë e burimeve të energjisë në BE-në deri në vitin 2030

Duke marrë parasysh të gjitha këto gjëra, Dokumenti i Gjelbër bën thirrje për veprim intensiv në tri fusha:

- Aksione të qarta në pjesën e politikave të kërkesës, duke pasur parasysh se aktivitetet që lidhen me politikat e furnizimit janë më të vështira për realizim (ana e kërkesës në këtë drejtim është shumë më premtuese);

- Ndryshime të vërteta dhe tektonike në sjelljen e konsumatorëve, si një mjet për arritjen e ndryshimeve në kërkesë;

- Luftë kundër ngrohjes globale në aspektin e furnizimit me energji, duke forcuar zhvillimin e kapaciteteve të burimeve të reja dhe të ripërtëritshme të energjisë;

Dekada e kaluar, Komisioni Evropian miratoi tre plane aksionare, në të cilat janë shkruar pengesat kryesore për zhvillimin e efikasitetit energjetik, e në të cilat përcaktohen aksionet dhe zgjidhjet konkrete për t'i tejkaluar këto probleme.

"**Plani i parë aksionar për efikasitetin energjetik në Bashkimin Evropian**" (COM (2000) 247) u publikua më 26 prill 2000. Plani aksionar pasoi pas komunikimit të Komisionit, të miratuar në prill të vitit 1998 në lidhje me përdorimin racional të energjisë dhe rezolutës së Këshillit të efikasitetit energjetik. Qëllimi i tij ishte që të përmirësohet shfrytëzimi i energjisë, gjegjësisht reduktimi i konsumit, por jo në kurriz të pajisjeve dhe komfortit. Ky dokument fokusohet në dy fusha të ndërhyrjes: promovimin e ndryshimeve në mënyrën e sjelljes së konsumatorëve në të gjitha nivelet dhe zëvendësimin e metodave të punës dhe teknikave të prodhimit me ato që harxhojnë më pak energji. Propozon edhe një gamë të gjerë të instrumenteve dhe aksioneve në drejtim të realizimit të rezultateve të dëshiruara, edhe atë në dy fusha:

- Masat e përfshirjes së efikasitetit energjetik në politikat e tjera të përbashkëta;

- Iniciativat për përforcimin dhe zgjerimin e politikave tashmë ekzistuese;

- Politikat dhe masat e reja;

Ky plan aksionar, në fakt drejton rrugën kah zhvillimi i mëtejshëm i akteve më të rëndësishme ligjore të BE-së. Në fakt, ai thekson rëndësinë e zhvillimit të kornizës rregullative në këto fusha:

- Aparatet shtëpiake, pajisjet komerciale dhe llojet e tjera të pajisjeve (sigurimi i skemave bashkëkohore për shënim dhe standardet minimale për konsum);

- Efikasiteti energjetik në ndërtesa (Plani aksionar sugjeron shtimin e njërit prej direktivave kyçe të kësaj fushe - Direktivën 93/76/ESS për certifikimin energjetik të ndërtesave dhe krijoi parakushte për zhvillimin e Direktivës së fundit 2010/31/EU për Karakteristikat energjetike të ndërtesave);

- Zotimet për të përfshirë efikasitetin energjetik në prokurimin publik;

- Kontrollet energjetike në industri dhe sektorin terciar;

**"Plani i dytë aksionar për efikasitetin energjetik"**, u publikua nga Komisioni më 19 tetor 2006 (COM (2006) 545). Ky dokument ofron një pamje bashkëkohore të problemeve, si dhe ofron zgjidhje për BE-në për periudhën që vijon. Një nga qëllimet kryesore të tij ishte reduktimi për 20% i konsumit të energjisë deri në vitin 2020. Plani aksionar përfshin një qasje moderne dhe masa për përmirësimin e karakteristikave energjetike të produkteve, ndërtesave dhe shërbimeve, sigurimin e një procesi efikas të prodhimit dhe të furnizimit, zvogëlimin e ndikimit të trafikut mbi konsumin e energjisë, lehtësimin e financimit dhe të investimeve në këtë sektor, inkurajimin dhe forcimin në drejtim të shprehive për shfrytëzimin racional të energjisë, si dhe një aksion më të gjerë ndërkombëtar për efikasitet energjetik.

Plani aksionar u përpoq t'i mobilizojë të gjithë aktorët relevantë (publikun, politikëbërësit dhe komunitetin e biznesit) në mënyrë që të ndryshohet tregu i energjetikës në përgjithësi. Ky plan, por edhe plani i mëparshëm, theksojnë teknikat e efikasitetit energjetik, shprehinë e konsumatorëve, si dhe produktet dhe shërbimet që mund të jenë më pak të varura prej energjisë, por njëkohësisht duke e ruajtur të njëjtën cilësi.

Plani i dytë aksionar identifikoi disa sektorë me potencial më të madh të kursimit: ndërtesa rezidenciale dhe komerciale (terciare) (27% / 30%), industria (25%) dhe trafiku (26%). Arritja e kursimeve të këtilla do të mundësonte kursimin e kostove të energjisë për rreth 100 miliardë euro çdo vit deri në vitin 2020 ose 390 Mtoe (tone ekuivalent të naftës) në vit. Ndikimi i CO<sub>2</sub>, sipas këtij skenari, do të ishte 780Mt më pak në vit.

Më 8 mars 2011, Komisioni Evropian miratoi komunikimin **"Plani për efikasitetin energjetik 2011"** (COM (2011) 109), i cili është dokumenti i tretë i kësaj sërë me radhë. Ky dokument, po ashtu përfshin masa konkrete me qëllim që të sigurohen përfitime të rëndësishme në fushën e ndërtesave rezidenciale, industrisë dhe administratës shtetërore. Në plan shprehet një shpresë për kursime prej 1 000 eurosh në vit për amvisëri, si

dhe për përmirësime të ekonomisë së Bashkimit përmes forcimit të konkurrencës. Ky plan parashikon edhe rritje të punësimit dhe krijimin e 2 milionë vendeve të reja të punës në gjithë BE-në.

Plani e ngrit efikasitetin energjetik si një komponent kryesor i politikës energjetike evropiane dhe paraqet një mbështetje shtesë në drejtim të arritjes së objektivit të BE 20/20/20.

- Zhvillimi ekonomik në aspektin e resurseve energjetike globale;

- Vendosja e sistemit të ulët emitues të karbonit;

- Rritja e qëndrueshmërisë energjetike të Bashkimit Evropian;

- Forcimi i sigurisë në furnizimin e energjisë;

Një vëmendje e veçantë u është kushtuar këtyre aktiviteteve: Përmirësimi i konceptit të karakteristikave energjetike të ndërtesave dhe nxitja e konsumit më të ulët të energjisë në sektorin e ndërtimit (rezidencial dhe terciar), zhvillimi i tregut për kompanitë që ofrojnë shërbime energjetike (EZSO), forcimi i konkurrencës së industrisë evropiane, aplikimi i skemave të kontrolleve energjetike, zhvillimi i instrumenteve financiare dhe dënime për ndotësit, aplikimi i karakteristikave energjetike (shënimi dhe eko-dizajni) për prodhimet (aparate) dhe aplikimi i planifikimit dhe qëllimeve të kursimeve në kuadër të vendeve-anëtare.

Së fundi, një gjë që nuk është më pak e rëndësishme, më 10 nëntor 2010, Komisioni Evropian miratoi komunikimin **"Energjia 2020 - Strategjia për energjinë konkurruese, të qëndrueshme dhe të sigurt"** (COM (2010) 639). Qëllimi i kësaj strategjie ishte që të arrihet një ndikim afatgjatë dhe të ndryshohet mënyra në të cilën Bashkimi Evropian prodhon dhe konsumon energjinë. Strategjia i tregon tre sektorët më të rëndësishëm, për të cilët duhet të ndërmerren aktivitete intensive. Ata janë: ndërtesat, transporti dhe industria - sektorët me potencialin më të madh për fitime (kursime) për një periudhë të shkurtër kohore. Vëmendje e veçantë në këtë dokument u kushtohet pesë fushave, edhe atë:

- Kufizimi i shfrytëzimit të energjisë në Evropë;

- Zhvillimi i tregut të integruar energjetik panevropian;

- Përforcimi i rolit të konsumatorëve dhe arritja e nivelit më të lartë të sigurisë;

- Zgjerimi i menaxhimit evropian në zhvillimin e teknologjisë evropiane dhe inovacioneve;

- Përforcimi i dimensionit të jashtëm në tregun energjetik të BE-së;

Të gjitha dokumentet e lartpërmendura strategjike dhe të

planifikimit paraqesin një bazë të mirë për zhvillimin e një kornize ligjore dhe ofrojnë një drejtim për aktivitetet e ardhshme. Të gjitha dokumentet pa një kornizë të fortë ligjore dhe pa një mbështetje në formën e një sërë aktesh juridike (direktiva, rregullativa, standarde teknike etj.) do të ishin vetëm një listë me dëshira.

## 1.2 Korniza ligjore e BE-së

Përveç kornizës së fuqishme strategjike që është përshkruar në kapitullin 1.1, Bashkimi Evropian kishte nevojë për një kornizë të fortë ligjore, e cila do të siguronte parakushte për shfrytëzimin e potencialit të madh të kursimeve energjetike. Duke filluar nga viti 2006 e deri më sot, Komisioni Evropian ka hartuar dhe miratuar 6 direktiva (5 prej tyre janë në fuqi), roli i të cilave ka një rëndësi të madhe në realizimin e qëllimeve strategjike të efikasitetit energjetik. Si një instrument për harmonizim ligjor në nivel të Bashkimit Evropian (dhe më gjerë), direktivat janë miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, me detyrimin që të gjitha shtetet anëtare t'i transportojnë dispozitat e tyre në legjislacionin e vendit. Për të gjitha direktivat ka afate për transportimin e tyre ndërmjet vendeve anëtare, e ato tashmë zbatohen.

### 1. Direktiva 2006/32/KE nga 5 prilli 2006 për efikasitet në konsumin final të energjisë dhe për shërbimet energjetike (Direktiva mbi Shërbimet Energjetike – DSHE)

Fokusi i kësaj direktive është i drejtuar kah konsumi final i energjisë. Ky akt ligjor ishte një nga shtyllat për zhvillimin e mëtejshëm të kornizës së përgjithshme të politikave në drejtim të efikasitetit energjetik. Direktiva aplikoi disa koncepte të reja që kanë shkaktuar ndryshime të mëdha në BE, por edhe në vendet jashtë saj (Shih kapitullin 1.3). Kthesën e parë që e shkaktoi direktiva ishte aplikimi i obligimit për vendet-anëtare që të vendosin caqet indikative për kursimin e energjisë. Caqet indikative duhet të jenë së paku 9% të konsumit të përgjithshëm të energjisë, krahasuar me 5 vitet e fundit, kurse anëtarët kanë të drejtë të vendosin edhe qëllime më ambicioze, në qoftë se mendojnë se mund ta realizojnë atë. Me qëllim që të sigurohet një monitorim adekuat i kursimeve të arritura në pajtim me metodologjinë e dhënë në Aneksin 1 të Drejtorisë, të gjitha vendet-anëtare duhet të caktojnë një ose më shumë organ/e/agjenci të

ri/reja dhe/ose ekzistues/e për kontrollin dhe përgjegjësinë e plotë mbi procesin e monitorimit dhe nivelin e realizimit të objektivave të kursimit.

Përveç kësaj, ndryshime të mëdha kanë ndodhur edhe në pjesën e prokurimit publik, ku të gjitha organet shtetërore janë të obliguara që ta përfshijnë efikasitetin energjetik si një kriter në procesin e furnizimit të mallrave (produkteve) dhe shërbime. Kjo direktivë, po ashtu u mundua të promovojë edhe tregun themelor të shërbimeve të energjisë, ka aplikuar konceptin e skemave të cilësisë së lartë të kontrollit energjetik, ka përforcuar mbështetjen e masave të efikasitetit energjetik, ka aplikuar detyrime për furnizuesit që ta masin konsumin etj. Ndryshimi tjetër i rëndësishëm ishte dispozita e nenit 14, e cila u bën thirrje vendeve-anëtare që ta përgatisin dhe t'i dorëzojnë Komisionit Evropian Planin Aksionar Kombëtar të Efikasitetit Energjetik (PAKEE) në çdo tre vjet. Plani i këtillë aksionar paraqet dokumentin themelor të planifikimit për secilën anëtare, ku do të publikohen objektivat kombëtare, masat e propozuara, shpjegimet në lidhje me burimet e mundshme financiare dhe kursimet e pritura, si dhe metodologjia e monitorimit (vëzhgimit) të rezultateve tashmë të arritura.

Sipas kësaj, mund të nxjerrim dy objektiva kryesore të këtij akti ligjor:

- Të sigurojë objektivat, mekanizmat, stimulimet e domosdoshme indikative, si dhe kornizën institucionale, financiare dhe ligjore për eliminimin e pengesave të tregut që mund ta vështirësojnë efikasitetin e konsumit të fundit;
- Të krijojë parakushte për zhvillimin dhe promovimin e tregut të shërbimeve energjetike dhe t'i afrojnë masat e tjera për përmirësimin e efikasitetit energjetik deri te konsumatorët e fundit;

Kjo direktivë veçanërisht ka të bëjë me sektorin publik, i cili është një sektor me një numër më të madh të mungesave dhe me një potencial më të lartë për kursime për një periudhë të shkurtër kohore, si edhe sektor i cili shërben si një shembull për aktorët e tjerë të kësaj fushe. Për të qenë shembull për të tjerët, opinionin, por edhe kompanitë relevante, duhet të jenë të informuar në mënyrë të suksesshme dhe të vazhdueshme për të gjitha masat e implementuara për efikasitetin energjetik, aktivitetet, zgjidhjet, burimet financiare dhe stimulimet.

Në këtë dokument janë të zhvendosura edhe rregullat e reja në fushën e furnizimit të energjisë. Në fakt, rregullat ekzistuese për shpërndarësit dhe kompanitë që shesin energjinë, të cilat ndërkohë janë




gjërësisht të zbatuara në Bashkimin Evropian, madje edhe në rajon, janë pikërisht rezultat i kësaj direktive. Në prapavijë, ideja ishte që të krijohen parakushte për llogaritjen e konsumit të energjisë dhe të sigurohet një sistem i qartë i pagesës në pajtim me konsumin real në një periudhë të caktuar kohore. Shpërndarësit e energjisë janë të obliguar që të sigurohen informata adekuate në faturat e energjisë, duke përfshirë të dhënat për energjinë e harxhuar për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, si dhe informata për konsumin mesatar për kategori të caktuara të konsumatorëve. Direktiva për shërbimet energjetike shkaktoi ndryshime të shumta pozitive në pjesën e efikasitetit energjetik të konsumi i fundit gjatë periudhës tetëvjeçare të zbatimit të saj.

## 2. Direktiva 2009/125/KE nga 21 tetori 2009 për krijimin e një kornize të eko-dizajnit për produktet që përdorin energji apo ndikojnë mbi konsumin e energjisë

Kjo direktivë vendos një kornizë për aplikimin e kërkesave të eko-dizajnit për produktet që përdorin energji. Qëllimi i kësaj direktive është të sigurohet një lëvizje e lirë e produkteve të tilla (që i rregullon kjo direktivë ose një dispozitë tjetër përkatëse) në tregun e brendshëm.

Termi "eko-dizajn" ka të bëjë me tërë procesin e projektimit të një produkti të caktuar në atë mënyrë që sigurohet se produkti shkakton një konsum minimal të energjisë gjatë gjithë jetës (projektim, prodhim, përdorim dhe vonesë të tij). Termi "produkte që ndikojnë mbi konsumin e energjisë", ka të bëjë jo vetëm me produktet të cilat për të funksionuar kanë nevojë për energji, por edhe me ato mallra (të mira) që në mënyrë indirekte shkaktojnë konsumin e energjisë (dritare, çezma, dushe etj).

Direktiva krijon një kornizë të rregullave të tregut dhe funksioneve individuale dhe përgjegjësi për vendet-anëtare, prodhuesit, furnizuesit dhe tregtarët, por edhe për të gjithë të tjerët të zinxhirit të tregut. Kjo direktivë ka të bëjë vetëm me ato produkte që janë të shënuara me shenjën "masat zbatuese" (dispozitë shtesë që përcakton kushtet




Në fotografi shenja "CE"

e veçanta teknike për një grup të caktuar të produkteve, siç janë: llambat shtëpiake, televizorët, motorët elektrikë etj.). Para se të plasohen në treg ose të lëshohen në përdorim, prodhimet që përdorin energji, e janë të shënuara me masat zbatuese, duhet patjetër të përmbushin kushte të caktuara. Në pajtim me këtë direktivë, nëse produktet plotësojnë kushtet, duhet të shënohen me simbolin "CE". Përveç shenjës "CE", për produktet e këtilla është e nevojshme edhe deklarata CE e konformitetit, me të cilën prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar garanton se produkti i plotëson rregullat përkatëse.

## 3. Direktiva 2010/30/BE nga 19 maji 2010 për shënim me etiketim dhe informata standarde për produktet dhe për resurset e tjera që ndikojnë mbi konsumin e energjisë

Kjo direktivë përcakton kornizën për etiketimin e produkteve që përdorin energji në mënyrë që të sigurojnë informata të standardizuara lidhur në konsumin e energjisë dhe resurset e tjera. Megjithatë, korniza nuk specifikon asnjë kufi apo nivel të performancave. Kjo direktivë vetëm ofron parakushtet dhe bazën ligjore për miratimin e direktivave dhe rregullatorëve shtesë që do të përcaktonin nivelet e performancave për një grup të veçantë të aparateve (makinat për larje, makinat për tharje, frigoriferët, kondicionerët, televizorët, makinat për larjen e enëve etj.)

Sistemi i përmendur për etiketimin e konsumatorëve ofron mundësi për krahasimin e produkteve në pajtim me nevojat energjetike gjatë punës së tyre. Në këtë mënyrë, konsumatorëve u jepet mundësia për të zgjedhur dhe për të blerë produkte energjetike-efikase me përdorimin e të cilave do të kursejnë energji dhe do të kontribuojnë për



Fotografia 2. Shembulli i etiketës energjetike për makinën e larjes së rrobave

reduktimin e harxhimeve të tyre. Kjo kornizë synon që në një mënyrë të caktuar t'i diskriminojë ato produkte që konsumojnë më shumë energji, që do të mund të rezultonte edhe me tërheqjen e tyre nga shitja. Këto skema të etiketimit zbatohen vetëm për ato produkte që janë të përfshira me direktiva të tjera përkatëse dhe rregullativa që parashikojnë kërkesa të caktuara dhe një metodologji për klasifikimin e energjisë. Me këto direktiva dhe rregullativa janë të përfshira vetëm ato produkte që kanë një ndikim të rëndësishëm direkt dhe/apo indirekt mbi konsumin e energjisë.

Direktiva përfshin detyrime për të gjithë aktorët e tregut – vendet-anëtare, prodhuesit, furnizuesit dhe tregtarët, duke siguruar njëkohësisht një rrjedhje të pandërprerë të produkteve të shënuara me etiketën energjetike. Direktiva, gjithashtu, u bën thirrje organeve shtetërore të këmbëngulin që gjatë prokurimit publik të blejnë produkte që janë të shënuara në mënyrë përkatëse, që kanë performanca më të mira dhe janë në grupin e produkteve me klasën e lartë energjetike.

#### **4. Direktiva 2010/31/BE nga 19 maji 2010 për karakteristika energjetike të ndërtesave**

Kjo direktivë i obligon të gjitha vendet-anëtare të aplikojnë kushtet minimale në lidhje me karakteristikat energjetike të ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese. Karakteristikat energjetike të ndërtesave janë të shprehura në numrin absolut, duke prezantuar kërkesat energjetike ose konsumimin e energjisë së ndërtesave për një metër katror në nivelin vjetor, të shprehura në kWh/m<sup>2</sup>. Përveç konceptit të karakteristikave minimale energjetike për ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese, ky akt përfshin skemat e certifikimit të ndërtesave, si dhe detyrimin për të kryer kontrollime të rregullta energjetike të sistemeve të ngrohjes (me kazanë për ngrohje) dhe të aklimatizimit, varësisht nga fuqia e tyre efektive.

Në këtë direktivë, një vëmendje e veçantë i kushtohet Bashkimit Evropian, duke pasur parasysh që ndërtesat përbëjnë afërsisht 40% të konsumit të përgjithshëm të energjisë. Sipas kësaj, ky sektor shihet si një nga sektorët më premtues për të arritur kursime të mëdha të energjisë dhe në atë mënyrë të kontribuohet në masë të madhe për arritjen e qëllimit të kursimit prej 20% të energjisë, në përputhje me strategjitë e BE-së për efikasitetin energjetik.

Objektivi kryesor i direktivës është avancimi i karakteristikave energjetike të ndërtesave, duke marrë parasysh kushtet klimatike dhe të motit, kushtet e brendshme klimatike, si dhe nivelin e harxhimeve optimale si parime themelore që përcaktojnë karakteristikat minimale

energjetike.

Ky akt është i ndarë në disa kapituj që mbulojnë fushat më të rëndësishme në kuadër të këtyre aktiviteteve. Pjesa e parë definon metodologjinë për llogaritjen e karakteristikave minimale energjetike, e cila është përshkruar plotësisht në Aneksin 1 të direktivës, e cila ka të bëjë me aspektet e mëposhtme:

- Karakteristikat ekzistuese termike të ndërtesave;
- Aparatet e ngrohjes dhe furnizimi me ujë të nxehtë;
- Sisteme për klimatizim;
- Ventilim natyror dhe mekanik;
- Sistemi i instaluar i ndriçimit;
- Projekt bazë, vendndodhja dhe pozicioni i ndërtesës;
- Sistemet pasive diellore dhe mbrojtja diellore;
- Kushtet e brendshme klimatike;
- Mbingarkesa e brendshme energjetike;

Pjesa e dytë dhe e tretë kanë të bëjnë me zbatimin e kushteve minimale energjetike për ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese (të cilat janë objekt i rinovimit), duke përfshirë elementet dhe njësitë e tyre të ndërtimit.

Në pjesën e katërt theksi vihet mbi planet nacionale për rritjen e numrit të ndërtesave me përafërsisht zero konsum të energjisë. Termi "Ndërtesa me afërsisht zero konsum të energjisë" nënkupton ndërtesë me efikasitet të lartë energjetik, në të cilën energjia shumë e vogël që nevojitet (afërsisht zero) është prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, që janë të instaluar në vendin e konsumimit ose në afërsi të menjëhershme, kurse vetëm një pjesë të vogël është nga jashtë. Pjesa që vijon shpjegon procesin e çertifikimit të ndërtesave dhe njësive të tyre ndërtimore.

Kjo direktivë (për dallim nga versioni i saj i mëparshëm i vitit 2002) përfshin një obligim të ri për kryerjen e kontrolleve të rregullta energjetike të sistemeve të ngrohjes dhe të klimatizimit në terësi. Vlerat kufitare të fuqisë efektive, të përcaktuara me direktivën e mëparshme për karakteristikat energjetike të ndërtesave mbeten të njëjta, gjegjësisht 20 kW për sistemet e ngrohjes me kazanë (kaldaje) dhe 12 kW për sistemet e klimatizimit.

Pjesa e fundit e dokumentit përfshin një sistem të pavarur për kontrollin e certifikatave të karakteristikave energjetike të ndërtesave dhe të raporteve të inspektimit, duke siguruar saktësinë dhe objektivitetin gjatë kryerjes së kontrolleve energjetike.

Pavarësisht përpjekjeve të mëdha dhe ndihmës ndërkombëtare përmes fondeve dhe institucioneve të ndryshme, në një pjesë të vendeve të rajonit këto skema të certifikimit ende nuk janë implementuar plotësisht.

### **5. Direktiva 2012/27/BE për efikasitetin energjetik**

Direktiva për efikasitetin energjetik është miratuar e fundit nga gjithsej pesë direktivat që kanë të bëjnë pikërisht me fushën e efikasitetin energjetik. Ky akt është një dokument gjithpërfshirës që ofron një pamje të plotë ndaj çështjeve që lidhen me efikasitetin energjetik dhe me të cilin plotësohen ose shfuqizohen aktet e tjera ligjore. Me direktivën e efikasitetit energjetik shfuqizohet Direktiva për shërbimet energjetike (2006/32/EC) dhe Direktiva 2004/8/EC për kogjenerim. Të dy direktivat shfuqizohen më 5 qershor 2014, kurse Direktiva për efikasitetin energjetik tashmë i rregullon, ndërsa në disa pjesë i përmirëson dispozitat e tyre.

Për dallim nga direktiva e mëparshme (Direktiva për shërbimet energjetike), direktiva e re nuk ka të bëjë vetëm me konsumatorët e fundit të energjisë, por edhe me furnizimin e energjisë.

Kjo direktivë vendos një kornizë të përbashkët për masat e avancimit të efikasitetit energjetik në BE. Akti ofron një mbështetje shtesë ligjore për të arritur 20% kursime të energjisë deri në vitin 2020, duke pasur parasysh se studiuesit dhe shkencëtarët kanë konstatuar se ky qëllim ambicioz nuk do të realizohet me mjetet dhe modele ekzistuese. Gjithashtu, direktiva këmbëngul që t'i heqë të gjitha pengesat që pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të koncepteve që lidhen me efikasitetin energjetik, ndërsa njëkohësisht teston rrugën për avancimin e efikasitetit energjetik edhe pas vitit 2020.

Në disa kapituj mbulohen fushat themelore rreth ndërhyrjeve të mundshme. Pjesa e parë përcakton objektivat e kursimit të energjisë duke i tejkaluar ato në Direktivën e shërbimeve energjetike, gjegjësisht përcakton një qëllim për konsumin maksimal (të lejuar) të energjisë nga energjia primare deri në vitin 2020 në nivelin e gjithë Unionit nga 1474 Mtoe.

Renovimi i ndërtesave është segmenti i dytë i rëndësishëm i kësaj direktive. Në këtë pjesë u bëhet thirrje vendeve-anëtare që të përgatisin strategji kombëtare për mobilizimin e investimeve që lidhen me renovimin e ndërtesave rezidenciale dhe komerciale.

Me qëllim që të forcohet roli i sektorit publik si shembull për të tjerët, për dallim nga Direktiva e shërbimeve energjetike, direktiva e re aplikon një obligim për të rinovuar së paku 3% të sipërfaqes së shfrytëzueshme të dyshemesë së ndërtesave në pronësi të organeve të

pushtetit qendror. Kjo dispozitë ka ngjallur një debat të gjerë në nivel të Unionit, kurse gjatë hartimit të direktivës u shpreh dyshimi në lidhje me mundësinë e zbatimit të dispozitës.

Direktiva ka të bëjë edhe me organet publike. Dispozitat e saj obligojnë institucionet që në kuadër të prokurimit publik të blejnë produkte, shërbime dhe ndërtesa me efikasitetin më të lartë energjetik.

Kjo direktivë aplikon skemat e detyrueshme për efikasitetin energjetik, si një dispozitë e re për furnizuesit dhe shpërndarësit e energjisë në mënyrë që të zvogëlohet sasia e energjisë së furnizuar për konsumatorët e fundit për 1.5% në vit.

Në këtë dokument, vëmendje të veçantë u kushtohet skemave të kontrollit energjetik, të cilat duhet të bëhen në të gjitha vendet-anëtare dhe të ofrohen për përdoruesit e fundit me një çmim të arsyeshëm dhe konkurrues.

Llogaritja e konsumit real të energjisë dhe sigurimi i informacioneve përkatëse (sipas kërkesës së mëparshme) për faturat e energjisë, po ashtu është pjesë e kësaj direktive.

Sa i përket furnizimit me energji, kjo direktivë krijon hapësirë për përfshirjen e mundshme të sistemeve të kombinuara mjaft efikase për prodhimin e njëkohshëm të energjisë elektrike dhe termike, si dhe për ngrohje dhe ftohje mjaft efikase si zgjidhje për përmirësimin e efikasitetit energjetik gjatë prodhimit dhe furnizimit.

Në pjesën e fundit, direktiva parasheh tregun e shërbimeve energjetike, nivelin e njohjes (kualifikimet), akreditimin dhe certifikimin, si dhe informatat, edukimet dhe trajnimet.

Përveç këtyre pesë direktivave që përbëjnë kornizën themelore ligjore të BE-së në kuadër të efikasitetit energjetik, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan më shumë se 30 direktiva të tjera, masa dhe/ose rregullore, të cilat së bashku përbëjnë sistemin e ndërlikuar dhe bashkëkohor të normave ligjore. Të gjitha rregulloret përcaktojnë kërkesat teknike dhe ato të tjera dhe kushtet për një grup të caktuar të produkteve (sidomos për eko-dizajn dhe shënim). Rregulloret dhe masat e zbatimit si aktet e unifikimit juridik (për dallim nga Direktivat që shërbejnë për harmonizimin ligjor) zbatohen drejtpërdrejt nga ana e vendeve-anëtare. Në atë moment kur Komisioni Evropian i miraton direktivat dhe ato hyjnë në fuqi, ato automatikisht zbatohen në të gjitha vendet-anëtare. Ky parim i zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë nuk vlen edhe për vendet që janë jashtë BE-së. Kjo do të thotë se vendet siç është Maqedonia nuk mund drejtpërdrejt t'i zbatojnë rregullativat e BE-së, por njësoj si me direktivat, ato mund të barten në një kornizë ligjore vendase.

### 1.3 Ndikimi ndaj vendeve jashtë BE-së

Pesë direktivat e përmendura janë pjesë e kornizës ligjore të BE-së. Si të tilla, ato nuk ndikojnë mbi vendet që janë jashtë BE-së, e as nuk janë ligjërish të obligueshme për komunat e tyre. Megjithatë, ndikimi i tyre mbi këto vende buron nga tre vendimeve të Këshillit Ministror të Bashkësisë së Energjisë, të miratuara në vitet 2009, 2010 dhe 2011.

Sipas marrëveshjes, një nga sfidat kryesore për Bashkësinë e Energjisë është zgjerimi i politikave të brendshme të BE-së drejt Evropës Juglindore dhe rajonin rreth Detit të Zi në formën e një kornize ligjërish të obligueshme. Në përputhje me qëllimin e Kontratës për Bashkësinë e Energjisë, ndërsa në kontekstin e krijimit të kornizës së qëndrueshme, rregulluese dhe tregtare për këto rajone, Këshilli Ministror miratoi tri vendime të përmendura më sipër. Nëpërmjet këtyre akteve, Këshilli Ministror vendosi që të zgjasë vlefshmërinë e së drejtës së përbashkët të BE-së nga fusha e efikasitetit energjetik për të gjitha shtetet kontraktuese të Traktatit të Bashkësisë së Energjisë. Me qëllim që të barten dispozitat në mënyrë përkatëse, janë miratuar tri vendime me afate të reja të zbatimit për të gjitha vendet kontraktuese.

- Vendimi: D/2009/05/MC-EnC deri më 18 dhjetor 2009;
- Vendimi: D/2010/02/MC-EnC deri më 24 shtator 2010;
- Vendimi: D/2011/03/MC-EnC deri më 16 korrik 2011;

Si rezultat i këtyre vendimeve, vendet-kontraktuese të traktatit të Bashkësisë së Energjisë (RM është një nga ato) janë të obliguara t'i bartin në legjislacionin vendas dispozitat e direktivave vijuese: Direktiva për shërbimet energjetike, Direktiva për etiketimin energjetik dhe Direktiva për karakteristikat energjetike të ndërtesave, kurse si rezultat i miratimit të këtyre direktivave, të obligueshme bëhen edhe masat, direktivat dhe rregullativat e tjera për zbatim. Siç vërehet, Direktiva për eko-dizajn nuk konsiderohet e rëndësishme në aspektin e bartjes së dispozitave të saj në legjislacionin vendas të vendeve-kontraktuese. Direktiva e fundit për efikasitetin energjetik ende nuk është miratuar nga Bashkësia e Energjisë, por në rrjedhje e sipër janë përgatitjet për qasjen dhe përshtatjet që do t'u imponohen shteteve kontraktuese, pas miratimit të saj.

### 1.4 Dispozita me ndikim të rëndësishëm në nivel lokal

Dispozitat e direktivave të BE-së nuk ndikojnë drejtpërdrejt mbi njësitë e vetëqeverisjes lokale as në vendet e BE-së, as në vendet e tjera, siç është Maqedonia. Sikurse aktet e harmonizimit ligjor, direktivat përcaktojnë vetëm kornizën ligjore për shtetet (vendet-anëtare). Megjithatë, vendet kanë përgjegjësi dhe të drejtë personale që vetë ta zgjedhin mënyrën se si do t'i bartin dispozitat në legjislacionin vendas, njëkohësisht duke mos e penguar konsistencën me aktet ligjore ekzistuese dhe duke i përshtatur në nivelin aktual të zhvillimit teknik dhe rrethanave të tregut. Me bartjen e direktivave, çdo vend përcakton kornizën e saj ligjore të ligjeve dhe të legjislacionit sekondar, e cila imponon obligime direkte për protagonistët përkatës, duke përfshirë edhe komunat.

Deri më tani Republika e Maqedonisë ka zhvilluar një sistem të plotë të akteve ligjore kombëtare (në përputhje me ato evropiane), në të cilin janë bartur dispozitat kryesore të direktivave që janë në fuqi. Kjo kornizë ligjore kërkon detyrime të mëdha dhe serioze për autoritetet publike (komunat) të cilat duhet të zbatohen në të ardhmen e afërt. Objektivi kryesor i masave të parapara është arritja e objektivave kombëtare për kursimin e energjisë, dekret i Qeverisë së RM-së dhe përmirësime të tjera lidhur me efikasitetin energjetik në nivel lokal dhe kombëtar. Dispozitat kryesore që dalin nga direktivat e përmendura, të cilat tashmë ekzistojnë ose do të barten, janë këto:

#### **Detyrimet që lidhen me Direktivën e shërbimeve energjetike**

Dispozitat e kësaj directive, veçanërisht kanë të bëjnë me organet dhe institucionet publike, kurse imponohen një sërë obligimesh në disa nene.

- Autoritetet publike (në të gjitha nivelet) do të marrin të gjitha masat dhe aktivitetet e mundshme për të kontribuar drejt realizimit të Objektivit kombëtar për kursimin e energjisë, të përcaktuara në Planin Kombëtar të Efikasitetit Energjetik (PKEE) apo dokumentet e tjera;

- Sektori publik duhet patjetër të zërë një pozitë udhëheqëse dhe të shërbejë si shembull për të tjerët në zbatimin e masave të efikasitetit energjetik. Për këtë qëllim, autoritetet publike do të zbatojnë masat në fazat e më hershme dhe do të bëjnë përpjekje shtesë që ato të prezantohen

në publik. Sektori publik duhet të fokusohet në masat e nivelit ekonomik të justifikuar dhe në atë se cilat masa do të gjenerojnë kursime më të mëdha energjetike për periudhën më të shkurtër kohore. Përmes fushatave të forta promovuese dhe informuese, fitojnë përvoja, njohuri, plane të prokurimit publik, zgjidhje teknike, praktika më të mira e të ngjashme, duhet të shpërndahen gjerësisht.

- Të gjitha organet publike kanë obligim të zgjedhin (të paktën në nivel kombëtar) së pakut dy nga gjashtë masat energjetike-efikase për prokurimin publik dhe t'i zbatojnë. Gjashtë masat për prokurimin publik janë të shkruara në Aneksin VI të direktivës dhe janë në kontekstin e rolit udhëheqës të sektorit publik. Ne i bëjmë thirrje organeve publike:

- 1) Të përdorni instrumente financiare për kursimin e energjisë, duke përfshirë kontraktimin mbi performancën energjetike?
- 2) Të furnizojnë pajisje dhe automjete në bazë të listave të specifikimeve për efikasitetin energjetik të prodhimeve, të përgatitura nga autoritetet dhe agjencitë përgjegjëse;
- 3) Të furnizojnë pajisje që ka konsumin më të ulët të energjisë në të gjitha regjimet, duke përfshirë edhe regjimin stand-by;
- 4) Të zëvendësojnë ose rinovojnë pajisjet dhe automjetet ekzistuese me modele të reja energjetike-efektive;
- 5) Të kryejnë kontrolle energjetike dhe t'i implementojnë rekomandimet në nivelin e shpenzimeve optimale;
- 6) Të blejnë ose të marrin me qira ndërtesa apo njësi të tyre me efikasitet energjetik dhe karakteristika më të larta energjetike;

#### **Detyrimet që lidhen me Direktivën e eko-dizajnit**

Edhe pse kjo direktivë nuk është e detyrueshme (në pajtim me të drejtën e përbashkët të Bashkësisë Evropiane të Energjisë në kontekstin e efikasitetit energjetik), Republika e Maqedonisë ka bërë një hap përpara dhe ka miratuar Rregulloren për eko-dizajn, në të cilën janë bartur masat e kësaj direktive së bashku me masat e tjera të implementimit.

Direktiva nuk ka dispozita të veçanta për organet publike në nivel lokal, por, megjithatë, ndikojnë ndaj autoriteteve komunale. Kjo do të thotë se komunat duhet të jenë të vetëdijshme për kërkesat për eko-dizajn (dhe produktet e shënuara me masat e implementimit në përputhje me Rregulloren në Maqedoni) dhe të blejnë vetëm pajisje që është shënuar në mënyrën adekuate me shenjën CE dhe kanë një deklaratë të konformitetit.

Kështu, komunat mund të jenë të sigurta se përdorin produkte që janë plotësisht në përputhje me kërkesat për eko-dizajn dhe shpenzojnë një sasi minimale të energjisë në jetën e tyre të punës.

#### **Detyrimet që lidhen me Direktivën e etiketimit energjetik**

Ngjashëm si Direktiva e mëparshme (për eko-dizajn), kjo direktivë nuk përmban shumë detyrime për organet publike në nivel lokal. Megjithatë, parakushti kryesor dhe shumë i rëndësishëm që është dhënë në nenin 9 të direktivës i detyron të gjitha organet publike (duke përfshirë edhe komunat) të blejnë vetëm produktet që kanë etiketën adekuat energjetike dhe përmbajnë gjithë dokumentacionin teknik. Në procesin e prokurimit publik, prioritet duhet t'u jepet produkteve të klasës më të mirë energjetike në të njëjtat kushte. Sipas këtij neni, të gjitha organet publike të blejnë produkte të cilat janë në përputhje me kriteret dhe që kanë klasën më të lartë energjetike.

#### **Detyrimet që lidhen me Direktivën për karakteristikat energjetike të ndërtesave**

Kjo Direktivë kërkon një përpjekje dhe mund të madh nga autoritetet lokale. Aplikon një seri detyrimesh për të gjithë aktorët në vendet-anëtare, me një theks të veçantë në organet publike, që ndikon drejtpërdrejt mbi komunat. Prandaj, në përputhje me dispozitat e direktivës, komunat duhet:

- Të sigurojnë se të gjitha ndërtesat, përfshirë njësitë dhe pjesët shtesë (që i ndërtojnë për qëllimet e tyre) janë në përputhje me kërkesat minimale për efikasitet energjetik. Gjithashtu, para fillimit të ndërtimit, duhet të merret parasysh fizibiliteti teknik, mjedisor dhe ekonomik i efikasitetit të lartë të sistemeve alternative;
- Të sigurojnë se të gjitha ndërtesat ekzistuese, pjesët dhe elementet e tyre (që janë në pronësi të komunës ose janë përdorur nga ajo) që rinovohen, duhet të jenë në përputhje me kërkesat minimale për efikasitet energjetik.
- Të sigurojnë se sistemet teknike që përdoren në ndërtesat komunale (në rastin e ndërtimit të ndërtesave të reja, zëvendësimit ose rindërtimit të sistemeve tashmë ekzistuese teknike) i plotësojnë kriteret energjetike në përputhje me performancat e përgjithshme energjetike,



instalimin përkatës, dimensionet, adaptimet dhe kontrollin e sistemeve të instaluara teknike. Sistemet teknike në ndërtesa në kuadër të kësaj direktive janë:

1. Sistemet e ngrohjes;
2. Sistemet e ujit të nxehtë sanitar;
3. Sistemet e klimatizimit;
4. Sistemet e ventilimit;
5. Sistemet e ndriçimit.

- Sipas nenit 9 të Direktivës, të gjitha ndërtesat në të cilat janë vendosur organet publike, gjegjësisht ndërtesat në pronësi të tyre (duke përfshirë edhe komunat) duhet t'i plotësojnë kërkesat në përputhje me kriterin "ndërtesa me përafërsisht zero konsum të energjisë", deri më 31 dhjetor 2018. (deri më 30 qershor 2019 për Maqedoninë si vend kontraktues i Traktatit të Bashkësisë së Energjisë).

- Të gjitha ndërtesat komunale me një sipërfaqe të përdorur prej mbi 500m<sup>2</sup>, duhet të posedojnë një certifikatë për karakteristikat energjetike të ndërtesës, të lëshuar nga personi i autorizuar në përputhje me metodologjinë e definuar. Pragu i sipërfaqes së përdorur do të ulet në 250 m<sup>2</sup> deri më 9 korrik 2015. (Për Maqedoninë deri më 30 shtator 2015). Kjo certifikatë duhet të publikohet qartë në vendin e duhur ku mund të vërehet dhe të jetë e qartë dhe e dukshme për opinionin.

- Organet publike duhet të sigurojnë inspektime të rregullta teknike të sistemeve ekzistuese të ngrohjes dhe sistemeve të klimatizimit që përdoren në ndërtesën të cilën e posedon komuna, ose ku komuna është e vendosur. Këto inspektime duhet të kryhen për të gjitha sistemet e ngrohjes me kazanë (kaldaje), për ngrohje me fuqi efektive më të madhe se 20kW, si dhe për sistemet e klimatizimit me një fuqi efektive më të madhe se 12 kW. Inspektimet e rregullta duhet të kryhen në intervale të rregullta kohore, jo më të gjata se tre vjet.

### **Detyrimet që lidhen me direktivën e efikasitetin energjetik**

Direktiva e fundit që u miratua së fundmi nga Parlamenti Evropian ka një ndikim të rëndësishëm mbi autoritetet përkatëse publike dhe mbi komunat. Sipas dispozitave të direktivës, komunat në vendet-anëtare janë të obliguar që:

- Të japin kontributin dhe përpjekjen e tyre në mënyrë që të ndihmohet në arritjen e objektivave kombëtare për kursimin e energjisë, të

cilat janë të përcaktuara në përputhje me këtë direktivë. Korniza kohore për qëllimet kombëtare për vendet jashtë BE-së do të përcaktohen nga Sekretariati i Bashkësisë së Energjisë;

- Të sigurojnë renovimin e ndërtesave që i përdorin për punimin aktual në përputhje me strategjitë afatgjate kombëtare;

- Ngjashëm si dispozitat në Direktivën e shërbimeve energjetike, komunat duhet ta luajnë rolin udhëheqës dhe të shërbejnë si shembull për të tjerët nëpërmjet komunikimit efikas dhe zgjerimit të informatave lidhur me masat e zbatuara të efikasitetit energjetik, praktikat, përvojat më të mira etj.;

- Të blejnë vetëm produkte, shërbime dhe ndërtesa me efikasitetin më të lartë energjetik deri në atë masë kur është ekonomikisht më e dobishme dhe teknikisht e realizueshme;

- Të krijojnë dhe mirëmbajnë një sistem për menaxhimin e energjisë në njësitë e tyre organizative në mënyrë që të mundësohet një monitorim dhe kontroll i konsumit të energjisë dhe të harxhimeve, e të gjitha këto me qëllim të minimizimit të tyre.

## **2 Efikasiteti energjetik në Maqedoni**

### **2.1 Thelbi i strategjisë**

**Strategjia për avancimin e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020** u miratua nga ana e Qeverisë në shtator të vitit 2010. Si përgjigje e angazhimit për përmirësimin e efikasitetit energjetik, e cila paraqet një prioritet të rëndësishëm në sektorin energjetik, kjo strategji krijon një kornizë për përmirësimin e gjendjes së përdorimit të qëndrueshëm të energjisë përmes miratimit dhe implementimit të masave ligjore dhe rregullatore, përf forcimit institucional dhe kadrovik, masave sociale dhe financiare, si dhe një numritë madh të programeve dhe iniciativave teknike, të destinuara për konsumatorët.

Strategjia parasheh kursime të energjisë prej mbi 9% **deri në vitin 2018, në krahasim me harxhimin mesatar në periudhën pesëvjeçare 2002-2006 (147ktoe)**, duke promovuar njëkohësisht efikasitetin energjetik, si dhe monitorimin dhe verifikimin deri në vitin 2020.

### **Masat ligjore dhe rregullatore** përmbajnë:

- Përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar ligjor dhe rregullator (Ligji i ri përenergjetikë, ndryshimet e Ligjit për ndërtim, kompletimi i Rregullores për efikasitetin energjetik të ndërtesave, përpunimi i kodekseve energjetike për objektet ndërtimore, zbatimi i kontrolleve energjetike dhe certifikimi i kontrollorëve energjetikë)

- Përpunimin e mekanizmave përkatës ndihmës për rritjen e projekteve nga sfera e efikasitetit energjetik (ndihmë për formimin e kompanive për shërbime energjetike (ESCOs) dhe kontrata për realizim, formimi i Fondit të efikasitetit energjetik, intensifikimi i partneritetit publiko-privat (PPP), përmes të cilit komunave do t'u mundësohet një qasje deri te kapitali privat, shkëmbimi i përvojave në lidhje me projektet e lidhura me efikasitetin energjetik, këmbimi i përforcuar i teknikave të menaxhimit, fitimi i aftësive për uljen e harxhimeve, drejtimi i fokusit kah konsumatorët dhe përmirësimi i shërbimeve, kontrata afatgjatë ndërmjet sektorit industrial dhe Qeverisë për reduktimin e konsumit të energjisë (Leje pune për Mbrojtjen e Integruar dhe Kontrollin e ndotjes) me qëllim të promovimit të teknologjive më të mira që i ka në dispozicion ekonomia e Maqedonisë.

- Bashkëpunimin rajonal (pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare, qëllimi kryesor i të cilave është promovimi i efikasitetit energjetik, rrjetëzimi dhe bashkëpunimi që do të mundësojë shkëmbimin e përvojave dhe njohurive ndërmjet ekspertëve rajonalë nga reformat që janë zbatuar deri më tani në aspektin e efikasitetit energjetik dhe zhvillimit të tregut).

**Nën përforcimin e kapaciteteve institucionale,** Strategjia i definon detyrat individuale të Ministrisë së Ekonomisë dhe Agjencisë së Energjetikës, si dhe formon Grupin Mbikëqyrës (Komitet) - një grup ndër-institucional i ekspertëve nga faktorët më të rëndësishëm në Qeveri, Akademia, sektori civil, komuniteti i biznesit, përfaqësuesit e konsumatorëve etj.

Përforcimi i kapaciteteve përfshin gjithashtu edhe edukimin dhe masat për ngritjen e vetëdijësimit në të gjitha nivelet, si dhe trajnimet profesionale dhe certifikime të kontrolluesve energjetikë.

**Masat sociale** fillimisht fokusohen në efikasitetin energjetik të banesat sociale dhe strehimi, si dhe bllok tarifave për energji elektrike. Gjithashtu, si masë kryesore financiare në Strategji është paraparë themelimi i Fondit të efikasitetit energjetik.

Së fundmi, Strategjia identifikon dhe analizon iniciativat teknike (programet) në lidhje me harxhimin. Iniciativat janë grupuar në sektorë:

### **Ndërtesat rezidenciale:**

- Sistemi qendror për ngrohje në Shkup
- Efikasiteti energjetik në strehimin social
- Kodekset e ndërtimit dhe zbatimi/certifikimi i tyre
- Shënimi i aparateve energjetike dhe pajisjeve, si dhe standardizimi i tyre
- Zëvendësimi i stufave me dru me modele me efikasitet të lartë
- Info-pika; fushata informative për efikasitetin energjetik
- Shënimi dhe standardet për kontrollimin e karakteristikave energjetike të kazanëve për ujë të nxehtë dhe sistemet e klimatizimit
- Përkrahja financiare për personat fizikë për investim në domenin e efikasitetit energjetik
- Sistemet diellore dhe pompat e ngrohjes gjeotermale
- Masat energjetike-efikase në ndërtesat rezidenciale me shumë banesa:

- ✕ Ndërrimi i dyerve dhe dritareve;
- ✕ Izolimi i tavanëve;
- ✕ Izolimi i fasadave;
- ✕ Aplikimi i ndriçimit efikas në banesat dhe hapësirat e përbashkëta;

### **Ndërtesat komerciale dhe ato të shërbimeve**

- Implementimi i kodekseve të ndërtimit dhe certifikimi
- Inspektimet (kontrollat) e kazanëve, gjegjësisht sistemeve të klimatizimit
- Sektori i arsimit – rinovimi i shkollave
- Info-qendra, fushata dhe rrjeti ndërkomunal për efikasitetin energjetik
- Menaxhmenti energjetik dhe kontrolli i sektorit komercial dhe i shërbimeve
- Përmirësimi i efikasitetit të ndriçimit rrugor
- Shënimi i aparateve elektrike dhe i pajisjes, si dhe standardizimi i tyre
- Rinovimi i spitaleve
- Sistemet diellore dhe pompat e ngrohjes gjeotermale
- Efikasiteti energjetik dhe përgjegjësia e korporatave-shoqërore

### Industria

- Përmirësimi i procesit të prodhimit
  - ✕ Prodhimi më i pastër;
  - ✕ Lejet për Mbrojtje të integruar dhe kontrolle të ndotjes

(MIKN).

- Kontrollet energjetike
- Bashkëgjenerimi (prodhimi i kombinuar i energjisë termike dhe elektrike)

- Karakteristikat energjetike të ndërtesave jorezidenciale
- Përmirësimi i ndriçimit
- Ndryshimi i llojit të energjensit
- Mekanizmi për zhvillim të pastër (MZHP)
- Shfrytëzimi i ngrohjes së mbeturinave (jo MZHP)
- “Repartete zgjuara”
- Furnizimi me ajër të kompresuar
- Rendi i mirë shtëpiak
- Efikasiteti energjetik dhe përgjegjësia e korporatave-shoqërore

### Trafiku

- Rikuperimii flotës vendore të automjeteve rrugore
- Promovimi i sistemit të qëndrueshëm të trafikut në zonat urbane
  - ✕ Aplikimi i tramvajit në Shkup
  - ✕ Rikuperimi i autobusëve urbanë
  - ✕ Politikat e parkimit
  - ✕ Promovimi i shfrytëzimit më të madh të biçikletave

- Aplikimi i qendrës së integruar për menaxhim me trafikun
- Standardet e cilësisë dhe kostoja e karburanteve
- Ditë pa automobila
- Promocione për përdorim më të madh të trafikut ndërrurban

hekurudhor

- Zvogëlimet tati më për automjetet ekologjike

Strategjia parasheh kursime të energjisë në përputhje me Tabelën 1, të prezantuar më poshtë. Përveç këtyre kursimeve, përfitimet shtesë do të reflektohen edhe në aspektet financiare, sociale dhe natyrore.

Tabela 1. Kursimet energjetike sipas sektorëve (ktoe)

| Sektori                          | 2010         | 2011         | 2012         | 2013         | 2014          | 2015          | 2016          | 2017          | 2018          | 2019          | 2020          |
|----------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Ndërtesat rezidenciale           | 2.33         | 4.71         | 7.63         | 11.4         | 15.74         | 20.42         | 26.52         | 33.49         | 40.51         | 48.32         | 57.14         |
| Ndërtesat komerciale dhe publike | 1.45         | 2.98         | 4.96         | 7.53         | 10.83         | 14.85         | 18.43         | 21.62         | 24.19         | 26.54         | 28.60         |
| Industria                        | 17.7         | 36.8         | 40.96        | 45.32        | 63.53         | 72.49         | 80            | 84.06         | 90.45         | 90.76         | 90.09         |
| Trafiku                          | 3.31         | 7.79         | 12.55        | 17.86        | 22.99         | 28.21         | 33.20         | 38.70         | 44.63         | 51.94         | 60.48         |
| <b>Gjithsej</b>                  | <b>24.79</b> | <b>52.29</b> | <b>66.10</b> | <b>82.15</b> | <b>113.09</b> | <b>135.97</b> | <b>158.16</b> | <b>177.87</b> | <b>199.78</b> | <b>217.56</b> | <b>237.31</b> |

**Burim:** Strategjia për avancimin e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020, Shkup, 2010


Harxhimet e përgjithshme (llogaritur në mënyrën kumulative për periudhën 2010-2020) për implementimin e strategjisë janë vlerësuar në 522 milionë €, shpërndarja e të cilave sipas viteve është prezantuar në Tabelën 2.

Tabela 2. Shpërndarja e investimeve sipas sektorëve (milionë Euro/në vit)

| Sektori                          | 2010         | 2011         | 2012         | 2013         | 2014         | 2015         | 2016         | 2017         | 2018         | 2019         | 2020         |
|----------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Sektori rezidencial              | 11.1         | 11.6         | 12.4         | 17.2         | 18.9         | 19.6         | 26.2         | 31.8         | 34.5         | 43.9         | 52.4         |
| Ndërtesat komerciale dhe publike | 6.8          | 7.8          | 8.9          | 10.1         | 12.3         | 15.5         | 14.8         | 14.8         | 14.0         | 14.9         | 15.0         |
| Industria                        | 23.7         | 3.7          | 5.8          | 20.0         | 7.0          | 3.0          | 2.0          | 3.2          | 5.5          | 0            | 0            |
| Trafiku                          | 7.0          | 18.00        | 24.0         | 4.5          | 1.0          | 0            | 0            | 0            | 0            | 0            | 0            |
| <b>Gjithsej</b>                  | <b>48.59</b> | <b>41.14</b> | <b>51.06</b> | <b>51.83</b> | <b>39.22</b> | <b>37.09</b> | <b>40.99</b> | <b>46.83</b> | <b>50.06</b> | <b>53.87</b> | <b>61.43</b> |

**Burim:** Strategjia për avancimin e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020, Shkup, 2010





Masat e propozuara kërkojnë një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare, të cilat përveç nga Qeveria, do të duhej të vinin edhe nga burime të tjera. Kjo do të thotë se paralelisht me përpjekjet e Qeverisë në sektorin e ndërtimit, duhet të investojnë dhe të tjerët, siç janë: komunat, donatorët / institucionet ndërkombëtare financiare, si dhe konsumatorët privatë. Sa i përket sektorit industrial, të gjitha investimet shkojnë në kurriz të

pronarëve, ndërsamasat më të rëndësishme për efikasitetin energjetik në trafik duhet të mbështeten nga Qeveria (Grafiku 1).

## 2.2 Aktivitetet e tjera

Legjislacionin dhe rregullativën e miratuar në sferën e efikasitetit energjetik e përbëjnë:

- Dekreti i qëllimeve indikative për kursimin e energjisë në Republikën e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.112/2011)
- Dekreti për eko-dizajnin e prodhimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.100/2011)
- Rregullorja për shënimin e harxhimit të energjisë dhe resurset e tjera të prodhimeve që shfrytëzojnë energji (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 154/2011 dhe 146/2011)
- Rregullorja për stacionet e kombinuara me efikasitet të lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 128/2011)
- Rregullorja për karakteristikat energjetike të ndërtesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 94/2013)
- Rregullorja për kontrollim energjetik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.94/2013)

Nëqershor 2013, Maqedonia ia ka dorëzuar Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike Planin aksionar kombëtar (PAK). Plani i dytë aksionar kombëtar përfshin një qasje më pragmatike, me të cilën

**kursimet përfundimtare energjetike do të arrihen përmes planit të njëjtë, por me hapa shumë më të përshpejtuar.**

Sa i përket përfundimit të qasjes deri te financat dhe kapacitetet institucionale, Ministria e Ekonomisë nëpërmjet projektit të mbështetur nga Banka Botërore, përgatiti një program kombëtar (i cili është në fazën e miratimit nga ana e Qeverisë) që përfshin **krijimin e fondit të ripërtëritjes, fokusi kryesor i të cilit është financimi i avancimit të efikasitetit energjetik në ndërtesat publike.**

Edhe pse kanë kompetenca të mëdha, institucionet që janë përgjegjëse për efikasitetin energjetik nuk posedojnë kapacitete dhe mjete përkatëse për t'i zbatuar ato, gjë që e vështirëson procesin e efikasitetit të politikave në veprime konkrete. Kjo situatë mund të tejkalohet me shfrytëzimin e përvojës së gjatë të ekspertëve që punojnë në zbatimin e skemave lokale energjetike-efikase, si dhe përmes modelit të Fondit për zhvillimin e bujqësisë, i cili ka një strukturë të ngjashme me atë që propozohet për Fondin e efikasitetit energjetik.

Edhe pse efikasiteti energjetik si i tillë ende nuk është pjesë e buxhetit si një pikë e veçantë, **investimet e këtuja janë një pjesë përbërëse e rinovimit dhe/ose programeve të ndërtimit në një sërë sektorësh, siç janë arsimi dhe shëndetësia.** Përveç kësaj, **një pjesë e komunave janë të suksesshme në implementimin e projekteve më të vogla të sferës së efikasitetit energjetik**, ndërsa disa kanë përfituar nga programi i fundit për financim nga ana e Bankës Botërore. Megjithatë, njësitë e vetëqeverisjes lokale ballafaqohen me vështirësi të mëdha financiare dhe teknike, veçanërisht në komunat rurale.

Pagesa në bazë të matësve individualë është iniciuar vetëm për një pjesë të shfrytëzuesve të ngrohjes qendrore, por jo edhe në një mënyrë përfshirjeje sistematike. Në këtë drejtim nevojiten përpjekje shtesë, si për shembull **subvencione për banorët, e të gjitha këto me qëllim që të arrihet kursimi i energjisë.**

Themelimi i sistemave të integruar për monitorim dhe verifikim të kursimeve energjetike të arritura është gjithashtu një nga faktorët identifikuar dhe të rëndësishëm për t'u matur avancimin e pajtim me Planin e dytë aksionar kombëtar në lidhje me qëndrimet e përcaktuara.

## 2.3 Mekanizmat financiare në dispozicion

Instrumentet e financimit që janë të rëndësishme për Maqedoninë dhe në përgjithësi për rajonin e Ballkanit Perëndimor i përfshin:

- Instrumentet financiare dhe fiskale
  - ✕ huazimet dhe grantet nga institucionet ndërkombëtare financiare, Komisioni Evropian dhe donatorët bilateralë
  - ✕ financimet e brendshme (harxhimet buxhetore)
  - ✕ tatimet energjetike
  - ✕ përshtatjet e çmimeve
- Mekanizmat për dërgesë
  - ✕ Krijimi i tregut për kompani ESCO
  - ✕ obligimet ligjore për furnizuesit
  - ✕ Fondet e efikasitetit energjetik
  - ✕ Agjencitë e efikasitetit energjetik

Qasja deri te financat është faktori kyç për të gjithë personat përgjegjës për efikasitetin energjetik. Plani i dytë aksionar kombëtar thekson se do të themelohet ndonjëllë buxheti nacional për këtë qëllim, por megjithatë në pajtim me këtë dokument theksi vihet mbi përgjegjësinë e sektorit privat.

Përveç mbështetjes së suksesshme nga ana e Bankës Botërore për projektet e efikasitetit energjetik në ndërtesat publike dhe në krijimin e modelit "ESCO" (fond iripërtëritjes), thirrja e kohëve të fundit e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim – Programi rajonal për efikasitetin energjetik, gjithashtu, ndihmoi në theksimin e disa nga pengesat kryesoretë shtetit në zbatimin e masave të efikasitetit energjetik, siç është korniza rregullatore, që është e domosdoshme për t'u lehtësuar financimi i komunave, themelimi i kompanive ESCO dhe financimi i investimeve përmes marrjes së kredive.

Në Tabelën 3 janë dhënë bankat që ofrojnë kredi me dedikim, që janë të dedikuara për efikasitetin energjetik. Përveç kësaj, tabela përfshin detaje për bankat që ofrojnë linja kreditore financiare nëpërmjet Bankës Evropiane të Investimeve për investime mbi efikasitetin energjetik, të dedikuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

| Institucioni financiar                                    | Fondi                                              | Struktura                                        | Madhësia e fondeve  | Lartësia e kredisë                                                                                                                                   | Shfrytëzuesi i fundit i përmirësuar                                                                                                    |
|-----------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|--------------------------------------------------|---------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Halk banka                                                | Green for Growth Fund Southeast Europe             | Kredia me ndihmë teknike                         | 5 milionë Euro      | Deri më 100 k€                                                                                                                                       | Amvisëritë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kompani që ofrojnë shërbime energjetike kompani nga domeni i energjisë së ripërtëritshme |
| Halk banka                                                | Banka Evropiane e Investimeve (BEI)                | 100% kredi                                       | Nuk është precizuar | Kredi investuese<br>Mikrokompani deri më 26.7 k€<br>Kompani të vogla deri më 266.7 k€<br>Kompani të mesme deri më 2666.7 k€                          | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme                                                                                                       |
| Banka Komerciale                                          | Fondet personale                                   | 100% kredi                                       | Nuk është precizuar | Përafërsisht deri më 5k€                                                                                                                             | Amvisëritë                                                                                                                             |
| Banka Komerciale                                          | Banka Evropiane e Investimeve (BEI)                | 100% kredi                                       | Nuk është precizuar | Furnizimi me material, Punëdore, Kredipërmikrondërmarrjedër më 45 k€, Kredipërndërmarrjetëvogladerimë 450 k€, Kredipërndërmarrjetëmesmederimë 3.5 M€ | Ndërmarrjet e vogladhetëmesme, sidhekomunat                                                                                            |
| Banka Komerciale                                          | Linja italiane kreditore                           | 100% kredi                                       | Nuk është precizuar | 50 k€ deri më 400 k€                                                                                                                                 | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme                                                                                                       |
| Unibanka nga Shkupi                                       | Fondet personale                                   | 100% kredi                                       | Nuk është precizuar | Shuma maksimale e kredisë varet nga nevojat e klientit dhe biznesit                                                                                  | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme                                                                                                       |
| NLB Tutunska Banka                                        | Banka Evropiane e Investimeve (BEI)                | 100% kredi                                       | Nuk është precizuar | deri më 2 M€                                                                                                                                         | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe komunat                                                                                           |
| Halk Banka                                                | EBRD EëBSEFF                                       | 100% kredi NT e financuar nga një fond i veçantë | 3 M€                | deri më 2 M€                                                                                                                                         | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme                                                                                                       |
| Ohridska Banka                                            | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim EëBSEFF | 100% kredi NT e financuar nga një fond i veçantë | 5 M€                | Prej 100 k€ deri më 2 M€                                                                                                                             | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme                                                                                                       |
| Ohridska Banka                                            | Banka Evropiane e Investimeve (BEI)                | 100% kredi                                       | 50 M€               | Prej 10 k€ deri më 3.5 M€                                                                                                                            | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe komunat                                                                                           |
| Pro Kredit Banka                                          | Banka Evropiane e Investimeve (BEI)                | 100% kredi                                       | Nuk është precizuar | Prej 5 k€ - 667 k€                                                                                                                                   | Amvisëritë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, komunat                                                                                  |
| Pro Kredit Banka                                          | Me siguri fondet personale                         | 100% kredi                                       | Nuk është precizuar | Amvisëritë: prej 10 k€ deri më 80 k€<br>Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme: deri më 750 k€                                                             | Amvisëritë dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme                                                                                        |
| Drejtëpërdrejt Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim | WebSEFF                                            | Kredi prej 78% me grant prej 17% dhe NT prej 5%  | Nuk është precizuar | Prej 2 M€ deri 6 M€                                                                                                                                  | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme                                                                                                       |

NT- ndihmë teknike

WebSEFF- West Balkan Sustainable Energy Financing Facility

### **3 Pikëpamjet dhe qëndrimet e komunave maqedonase, organizatave joqeveritare dhe kompanive**

#### **3.1 Projekti „Dialogu publik për përdorim të qëndrueshëm të energjisë në Evropën Juglindore”**

Projekti "Dialogu publik për shfrytëzimin e qëndrueshëm të energjisë në Evropën Juglindore" ishte nisur nga Rrjeti i shkollave të politikave publike në Evropën Juglindore, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, kurse i mbështetur financiarisht nga Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, përkatësisht Fondi i Hapur Rajonal për efikasitet energjetik (GIZ-ORF-EE) dhe Fondacioni Konrad Adeauer. Qëllimi kryesor i projektit ishte përforcimi i dialogut midis përfaqësuesve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe midis sektorit civil dhe komunitetit të biznesit, gjegjësisht midis të gjitha palëve të rëndësishme në fushën e efikasitetit energjetik dhe politikave që lidhen me të. Përveç kësaj, dialogu kishte për qëllim që t'i identifikojë pengesat, sfidat dhe problemet ekzistuese gjatë implementimit të politikave dhe investimeve që lidhen me efikasitetin energjetik, në lidhje me kornizën ligjore, financat, barrierat institucionale, resurset njerëzore etj.

Zbatimi i projektit "Dialogu publik për shfrytëzimin e qëndrueshëm të energjisë në Evropën Juglindore" në Maqedoni është bazuar mbi analizën në terren. Domethënë, për të mbledhur informacione dhe të dhëna të qarta e të drejtpërdrejta mbi politikën e efikasitetit energjetik, përpjekjet dhe sfidat e komunave, organizatave joqeveritare dhe komunitetit të biznesit, GIZ-ORF-EE dhe Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave (QHKP) kanë kryer një hulumtim në terren në të tetë rajonet e planifikuara (statistikore) në gjithë vendin. Në këtë mënyrë janë detektuar problemet e përbashkëta të të gjitha rajoneve, por janë identifikuar problemet dhe pengesat që janë karakteristike për një rajon të veçantë. Brenda gjashtë muajve, GIZ-ORF-EE dhe QHKP-ja kanë mbajtur gjithsej tetë debate publike, edhe atë në Rajonin e Shkupit (Shkup), Rajonin e Vardarit (Veles), Rajonin e Pellagonisë (Manastir), Rajonin Juglindor (Strumicë), Rajonin Lindor (Shtip), Rajonin Jugperëndimor (Ohër), në Rajonin e Pollogut (Gostivar) dhe në Rajonin Verilindor (Kumanovë). Në të tetë debatet ishin të ftuara komunat dhe organizatat më të rëndësishme joqeveritare dhe firmat, në fokusin e të cilave është efikasiteti energjetik dhe që gjenden në

rajonin e planifikuar përkatës.

Njëra pjesë e debateve publike përfshinte prezantime lidhur me këtë çështje, ndërsa pjesa tjetër ishte e hapur për diskutime. Në pjesën e parë u mbajtën tri ligjërata. Përveç definicionit të efikasitetit energjetik dhe përfitimeve të tij (kursimet financiare, reduktimi i ndotjes, përmirësimi i komfortit), në prezantimin e parë u analizuan edhe mundësitë se si ndërtesat publike të paraqesin një shembull të mirë për shfrytëzimin e qëndrueshëm të energjisë. Për shfrytëzimin racional të energjisë ishin përmendur këto masa: ndryshimi i shprehive lidhur me shfrytëzimin e energjisë, vendosja e izolimit termik në fasada, zëvendësimi i dritareve, vendosja e ndriçimit të ri dhe modernizimi i sistemeve të ngrohjes dhe të ftohjes. Janë theksuar edhe disa shembuj nga Kroacia, si ai i qytetit të Sisakut me qëllim që të jepet një shembull i vërtetë dhe real për përfitimet e efikasitetit energjetik.

Në fakt, në Sisak janë kryer disa rikonstrukcione dhe riparime të ndërtesave publike në vitet e fundit, siç është shembulli me shkollën fillore "23 Qershori" dhe pishinën lokale. Në rastin e dytë, ujërat e zeza me ngrohje shtesë përdoren në sistemin e ngrohjes, e si rezultat i kësaj pune realizohen kurse prej rreth 8500 €. Kthimi i investimit pritet për 2.5 vjet. Në shembullin e shkollës fillore, pas zëvendësimit të kazanit (kaldajës) të vjetër me një të ri me gaz, është regjistruar një kursim prej rreth 55.000 €, ndërsa pritet fondet e investuara të kthehen po ashtu për 2.5 vjet. Në kuadër të prezantimit të parë është theksuar rregullisht se për të arritur rezultate të qëndrueshme dhe përforcim të efikasitetit energjetik, është e domosdoshme që të organizohen fushata masive, promovime dhe infopika, ndërsa është theksuar se mbështetja nga ana e palëve shoqërore është më shumë se e nevojshme. Mbi të gjitha, mbështetja e këtillë është veçanërisht e rëndësishme për të krijuar një bazë qendrore të dhënash, e cila do të azhurohet rregullisht, e që do të sigurojë informata të sakta rreth harxhimit total të energjisë nga ana e institucioneve publike - gjë që në Kroaci tashmë ekziston.

Prezantimi i dytë iu dedikua shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në nivel lokal. U theksua se për veprimet dhe politikën e tilla është jashtëzakonisht e rëndësishme që të ketë një kornizë të duhur ligjore (ligje, akte nënligjore, rregullore), si dhe një rrjet adekuat financiar (fonde, linja kreditore). Në këtë "pako", është gjithashtu shumë e rëndësishme ekzistenca e strategjive lokale dhe planeve aksionare që shërbejnë si udhërrëfytes për investimet e mëtejshme në pajtim me nevojat

dhe kapacitetet e secilit regjion veç e veç. Në këtë prezantim njëkohësisht është theksuar se komunat, organizatat joqeveritare, sektori i biznesit, por edhe qytetarët luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e masave të efikasitetit energjetik. Është vënë theksi edhe në faktin se komunat, së bashku me kompanitë, mund të nxisin investime shtesë të efikasitetit energjetik përmes PPP, sidomos në fushën e ndriçimit rrugor, biomasës dhe mbeturinave. Është theksuar edhe nevoja e bashkëpunimit dhe komunikimit midis komunave dhe organizatave joqeveritare lidhur me shfrytëzimin e fondeve ndërkombëtare, si një burim alternativ i financimit dhe investimit në projekte që synojnë përmirësimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të energjisë. Nga fundi i prezantimit, u theksua rëndësia të cilën e kanë qytetarët në këtë proces me investimet dhe veprimet personale, siç janë: vendosja e kolektorëve diellorë, pompave gjeotermale dhe pompave të ngrohjes, izolimet e fasadave, zëvendësimi i dritareve - investime me të cilat mund të zvogëlohen shpenzimet e energjisë edhe për 80%.

Me prezantimin e tretë, theksi kryesor u vu mbi varfërinë energjetike. Në pjesën hyrëse të këtij prezantimi, pjesëmarrësit u njohën me shkaqet kryesore të varfërisë energjetike: joefikasiteti energjetik, buxheti i dobët i familjes, si dhe me çmimin e energjensave. Përveç kësaj, u theksua fakti se paaftësia për të përmbushur nevojat themelore, si: ngrohja, gatimi dhe ndriçimi, janë rezultat i kulturës së jetës dhe shprehive në drejtim të shfrytëzimit të energjisë, por edhe si rezultat i infrastrukturës së vjetër. U theksua edhe se qytetarët, sipas gjendjes së tanishme, do të duhej të shpenzonin për 43% më shumë energji se sa shpenzojnë tani, me qëllim që t'i kënaqin nevojat e tyre. Megjithatë, kjo sipas panelistëve nuk do të thotë se amvisëritë kursejnë energji, por se nuk mund ta lejojnë atë. Për t'i tejkaluar këto probleme, përmes prezantimit përkatës, u rekomandua intensifikimi i investimeve të lidhura me efikasitetin energjetik në sektorin publik dhe privat, por edhe në amvisëritë me një theks të veçantë për njerëzit që janë në një situatë të keqe financiare, për të cilat do të sigurohen fonde të veçanta dhe burime financiare. Rekomandimet e tjera përfshijnë rinovimin e rrjetit të shpërndarjes, rritjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe ngritjen e vetëdijes publike për përfitimet e efikasitetit energjetik.

Prezantimet i bënë Zoran Bogunoviq dhe Darko Hecer (ekspertë ndërkombëtarë) dhe Igor Pančevski, Robert Sharlamanov, prof. Konstantin Dimitrov dhe Jasminka Kapac Dimitrova (ekspertë vendorë), ndërsa

debatet i moderoi Ilija Sazdovski. Gjetjet e debateve publike janë përmbledhur në kapitullin e ardhshëm, në mënyrë që të ketë një pasqyrë dhe pamje të qartë, në vazhdimësi është futur edhe një tabelë me të gjitha problemet dhe pengesat e zbuluara.

## 3.2 Debatet sipas rajoneve

Në analizën e mëposhtme do të prezantohen gjetjet nga çdo rajon veç e veç. Në këtë mënyrë, do të kemi një pasqyrë të qartë për potencialet, pengesat dhe mungesat e secilit prej rajoneve. Mbi këtë bazë, do të kemi mundësi të nxjerrim konkluzione për Maqedoninë në përgjithësi.

### 3.2.1 Rajoni i Shkupit

Nevoja për intensifikimin e gazifikimit të kryeqytetit të Maqedonisë ishte një nga temat kryesore gjatë debatit në Shkup. Në këtë drejtim u theksua nevoja për një qasje të sinkronizuar, sektori industrial dhe rezidencial duhet në mënyrë të barabartë të përfshihen në rrjet, sepse vetëm kjo mënyrë është profitabile dhe tërheqëse për të tërhequr investitorët.

Komunat përballen me një sërë barrierash që ngadalësojnë procesin e investimit kur është fjala për efikasitetin energjetik. Bllokada më e madhe paraqet mungesa të mjeteve financiare. Në fakt, edhe pse procesi i decentralizimit duhej të mundësonte vetë-qëndrueshmërinë e njësive lokale, duke përfshirë edhe investimin, renovimin dhe rekonstrukcionet e lidhura me efikasitetin energjetik, megjithatë ende mungojnë mjetet që do të ndahen për këtë qëllim.

Një problem tjetër është mungesa e një Fondi Kombëtar për Efikasitetin Energjetik. Komunat e Shkupit e shohin këtë fond si një burim që do ta intensifikonte procesin e investimeve dhe të rekonstrukcioneve. Sipas përfaqësuesve të komunave, krijimi i këtij fondi do të sigurojë një burim të qëndrueshëm të financimit të pjesshëm të aktiviteteve të këtilla. Ky fond do të ketë një rëndësi të madhe, sidomos për bashkëfinancim dhe plotësim me fondet e tjera.

Miratimi i Ligjit për efikasitetin energjetik është përmendur si një



zgjidhje e mundshme në mënyrë që të fitohet një pasqyrë e qartë dhe e detajuar e detyrave dhe procedurave në lidhje me sektorin publik dhe atë të biznesit kur është fjala për investimet që lidhen me efikasitetin energjetik. U theksua se ligji i këtillë do ta lehtësojë bashkëpunimin midis komunave dhe kompanive, veçanërisht në fushën e PPP.

Lidhur me PPP, përfaqësuesit e komunave dhe kompanive pranojnë se numri i partneriteteve të atilla është shumë i vogël. U theksua nevoja për rritjen e bashkëpunimit në këtë fushë, sidomos për shkak të faktit se një gjë e tillë është e dobishme për të dyja palët.

Pastaj, si një katalizator shtesë për investimet në fushën e efikasitetit energjetik është përmendur shënimi i lokacioneve për këtë qëllim ose ndërtimi i kapaciteteve të burimeve të ripërtëritshme të energjisë që në fazën e miratimit të planeve të detajuara urbanistike. Kjo u theksua njëkohësisht nga përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe nga kompanitë të cilat theksuan se këto hapa do ta lehtësojnë procedurën e investimit, por edhe do të ofrojnë një pasqyrë të qartë të zonave me një potencial të këtillë.

Gjatë debatit në Shkup u përmend një fakt interesant, i cili kishte të bënte me ndërtimin, gjegjësisht mungesën e punëtorëve të kualifikuar ndërtimorë në fushën e efikasitetit energjetik. Njëkohësisht, Maqedonia ka nevojë për afërsisht 10.000 punëtorë ndërtimorë, të cilët do të duhej të ishin plotësisht të angazhuar në aktivitetet e fushës së efikasitetit energjetik, por trajnuesit mund të trajnojnë prej 100 deri më 150 punëtorë të këtillë.

Biznesmenët që punojnë në këtë fushë i kanë bërë thirrje Qeverisë që të miratojë masa aktive, të cilat do ta përmirësojnë efikasitetin energjetik, sidomos midis popullatës. Një nga biznesmenët e pranishëm ilustroi:

*"Shqipëria dhe Kosova janë një hap përpara Maqedonisë. Shqipëria miratoi një vendim për tatim prej 200% mbi importet e llambave të thjeshta, kurse ne nuk kemi një masë të atillë në Maqedoni. Kosova, gjithashtu, ka tatim për importet e llambave të thjeshta me 0,20 euro".*

U përmend edhe se ekziston hapësirë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet vetë komunave, por edhe me komunitetin e biznesit. Në funksion të kësaj, u propozua organizimi më i shpeshtë i tryezave të rrumbullakëta, si një mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe ideve, rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe pjesëmarrjen në panaire rajonale dhe ndërkombëtare për të fituar njohuri në lidhje me mekanizmat më të fundit të efikasitetit energjetik.

### 3.2.2 Rajoni jugperëndimor

Gjatë debatit në rajonin jugperëndimor, që u mbajt në Ohër, komunat, organizatat joqeveritare dhe kompanitë i prezantuan pikëpamjet, sugjerimet dhe idetë e tyre se si të përmirësohet efikasiteti energjetik në Ohër, por edhe në komunat e tjera më të vogla që gravitojnë rreth këtij qyteti.

Një nga vërejtjet që u përmendën më shpesh nga të gjithë të pranishmit ishte nevoja urgjente për rritjen e vetëdijes publike në mesin e popullatës lokale lidhur me përfitimet e këtyre investimeve. Si një mënyrë e mundshme për të dalë nga situata momentale u sugjeruan fushata dhe promovime më të shpeshta dhe më të dukshme publike, sidomos në arsimin fillor dhe të mesëm (si fushata "Pakoja e gjelbër" që tashmë ekziston, por në një nivel shumë më të lartë).

Edhe në këtë rajon, përfaqësuesit e komunave theksuan nevojën për themelimin e Fondit të efikasitetit energjetik, me të cilin do të intensifikohej procesi i investimeve, duke pasur parasysh faktin se edhe ata ballafaqohen me burime dhe financa të kufizuara për aktivitete të lidhura me efikasitetin energjetik.

Për fat të keq, kapacitetet ekzistuese profesionale dhe të ekspertëve, që në fakt janë ende të dobëta, kontribuojnë për ritmin e dobët të aktiviteteve. Nga ana tjetër, komuniteti i biznesit i komunave ka kërkuar thjeshtimin dhe reduktimin e procedurave administrative, me të cilat do të kursehen koha dhe paratë.

Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin ndërmjet komunave dhe kompanive lokale, të dyja palët pranojnë nevojën për të forcuar PPP, sidomos me kompanitë ESCO. Si fushë më fitimprurëse për të dyja palët u theksua PPP për ndriçimin rrugor. Partneritetet e tilla janë të mirëseardhura edhe për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla në mënyrë që të përmirësohet imazhi rajonal lidhur me burimet e ripërtëritshme.

Komunat dhe kompanitë nuk qenë të vetmet ato që dhanë propozimet dhe idetë se si të përmirësohet efikasiteti energjetik. Organizatat lokale joqeveritare kanë theksuar nevojën për të qenë sa më të hapura komunat dhe kompanitë lidhur me bashkëpunimin e ndërsjellë. Këto organizata shohin një potencial të madh për një pjesëmarrje dhe aplikim të përbashkët para donatorëve të jashtëm dhe atyre vendas. Bashkëpunimi i rritur me sektorin joqeveritar do të rezultonte edhe me përmirësimin e pasqyrës së asaj se ku janë të nevojshme investime dhe

aktivitete të këtilla dhe të ngjashme. Sa i përket organizatave joqeveritare, kur bëhet fjalë për aplikimin për projekte, për ta pengesë paraqesin garancitë e duhura bankare, si dhe procedurat komplekse dhe dokumentacionin e kërkuar.

Është interesante se të gjithë pjesëmarrësit theksuan qasjen e kufizuar deri te informacionet e reja për metodat, mjetet dhe teknikat e reja në fushën e efikasitetit energjetik, diçka që është e dobishme për të gjitha palët e përfshira në procesin e përpunimit të investimeve dhe planeve të projekteve.

### 3.2.3 Rajoni lindor

Debati u hap nga kryetari i Komunës së Shtipit, z. Ilčo Zahariev. Ai përshëndeti iniciativën për organizimin e këtij debati dhe theksoi rëndësinë e tij për njësitë e vetqeverisjes lokale, duke theksuar se konkluzionet e këtij debati do të shërbejnë si udhërrëfyes në procesin e përpilimit dhe implementimit të politikave lokale për efikasitetin energjetik. Fjalimi përshëndetës dhe prania e kryetarit të komunës e demonstroi përkushtimin e Rajonit lindor për politikën e efikasitetit energjetik dhe rëndësinë e tyre në këtë proces.

Për komunat problemet me mjetet financiare dhe ekspertët janë një nga sfidat më të mëdha. Si rrjedhojë, krijimi i një Fondi Kombëtar për efikasitetin energjetik u theksua si një mënyrë për t'i zgjidhur këto pengesa. Po ashtu, u kërkuar edhe krijimi i një fondi të veçantë të dedikuar enkas për familjet private me fasada të papërfunduara - një problem që ndikon mbi harxhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike dhe ngrohjes. Megjithatë, problemet financiare nuk ndikojnë vetëm mbi proceset e investimit / renovimit / rikonstruksionit, por edhe mbi procesin e përgatitjes së studimeve të fizibilitetit. Në fakt, mungesa e parave u shkakton vështirësi komunave për të mbështetur programet dhe planet lokale ekologjike për efikasitet energjetik me studime të fizibilitetit, që ka një rëndësi thelbësore për tërheqjen e investorëve dhe financuesve. Pastaj, ata kërkuar një qasje më të lehtë deri te kreditë bankare dhe huazimet të cilat gjithashtu mund t'i përmirësojnë iniciativat e efikasitetit energjetik.

Përfaqësuesit e sektorit lokal të biznesit theksuan se rajoni lindor ka një potencial të madh për investime në biomasë, si dhe për PPP. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e komunave thanë se ky proces është vështirësuar

nga disa faktorë - vështirësi për sigurimin e garancave bankare, si një parakusht për nënshkrimin e kontratave dhe mungesa e një ligji të veçantë që ka të bëjë me efikasitetin energjetik që do të lehtësonte procedurën e investimit në fushën e efikasitetit energjetik. Në një situatë ku një ligj i tillë mungon, zyrtarët komunalë pohojnë se ata janë të detyruar të shkojnë nëpër një labirint ligjor gjatë përpunimit të kontratave për PPP dhe t'i përputhin ato me ligje të tjera të ndryshme, si Ligji mbi Prokurimin Publik dhe Ligji për energjinë, që merr shumë kohë.

Në lidhje me vetëdijen publike, demonstrimi i një zotimi të saktë, të dukshëm dhe të qëndrueshëm nga aktorët politikë (si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror) mbi investimet dhe aktivitetet ishin propozimet kryesore për ngritjen e vetëdijes publike. Sipas pjesëmarrësve, ndërgjegjësimi i opinionit në këtë fushë do të jetë një sinjal i qartë për sektorin privat dhe qytetarët që të përfshihen në aktivitetet e këtilla.

Ka rëndësi edhe konkluzioni se rajoni lindor ka nevojë për intensifikimin e procesit të gazifikimit, i cili do të kontribuojë për efikasitetin energjetik dhe për një ekonomi më të mirë lokale. Për këtë qëllim, komunat kanë shprehur gatishmërinë dhe interesimin për të marrë pjesë në zhvillimin dhe avancimin e rrjetit të shpërndarjes, por për ta bërë këtë, janë të domosdoshme ndryshimet dhe adaptimet ligjore.

### 3.2.4 Rajoni juglindor

Krijimi i Fondit Kombëtar për efikasitetin energjetik ishte një prej vërejtjeve më të shpeshta gjatë debatit në Strumicë. Përfaqësuesit komunalë theksuan se fondi do ta rrisë ritmin e investimeve, duke pasur parasysh se ky rajon, po ashtu, ballafaqohet me financa të kufizuara për qëllime të këtilla.

Megjithatë, financat nuk janë pengesa e vetme. Komunat më të vogla ballafaqohen me një mungesë të ekspertëve të kualifikuar, gjë që gjithsesi ndikon mbi intensitetin e aktivitetëve të lidhura me efikasitetin energjetik. Si një zgjidhje për këtë problem, u propozuan zyra të disperzuara të Agjencisë së Energjetikës së Republikës së Maqedonisë, të cilat do ta ndihmonin bashkëpunimin e ndërsjellë, si dhe krijimin e ekipeve të përbashkëta (ndërkomunale).

Debati i nxori në sipërfaqe dobësitë administrative dhe institucionale (të cilat ishin përmendur tanimë në debatin e mëparshëm),



procedurat e gjata dhe komplekse të përgatitjes së planeve të detajuara urbanistike (të paktën 6 muaj), që ndikon mbi durimin e investitorëve dhe mungesa e dokumentacionit të plotë të planifikimit. Sipas një pjese të përfaqësuesve komunalë, disa nga investitorët përballen me vështirësi edhe me kompaninë për distribuim të energjisë elektrike EVN në lidhje me inkuadrimit në rrjet. Në fakt, ata pretendojnë se kjo procedurë nganjëherë zgjat shumë kohë, gjë që kontribuon që disa prej tyre të tërhiqen nga qëllimi për të investuar.

Komunat dhe kompanitë e pranojnë se ekziston një potencial i madh kur është fjala për PPP, veçanërisht rreth biomasës nga bujqësia. Mbetjet bujqësore mund të jenë një burim i madh për përmirësimin e efikasitetit energjetik, duke marrë parasysh faktin se rajoni i Strumicës dhe rajoni juglindor janë një zonë ku bujqësia është më e zhvilluar.

Nga ana tjetër, organizatat lokale joqeveritare theksuan se komunat, sidomos ato më të voglat, nuk e përdorin potencialin e sektorit civil dhe përparimi lidhur me këtë problem është i detyrueshëm. Ashtu si në rajonin lindor, ky bashkëpunim mund të drejtohet kah ngritja e vetëdijes publike për efikasitetin energjetik, e cila ende nuk është në nivelin e duhur. Një arsye tjetër është edhe fakti që komunat nuk janë në gjendje që pavarësisht të organizojnë kampanja për efikasitetin energjetik për shkak të mungesës së mjeteve financiare në buxhetin komunal. Në pikëpamje të ngritjes së vetëdijes ishte theksuar nevoja që ajo të zhvillohet në dy nivele - fushata publike dhe aktivitete në kuadër të procesit arsimor.

### 3.2.5 Rajoni i Pellagonisë

Çdo debat ishte një shans për të marrë të dhëna dhe informacione të reja. Ky ishte rasti edhe me Rajonin e Pellagonisë. Fakti më interesant ishte rreth (mos)angazhimit të kryetarëve të komunave për efikasitetin energjetik. Në fakt, sipas disa prej përfaqësuesve të komunave, një pjesë e kryetarëve të komunave kanë një interes të kufizuar për efikasitetin energjetik dhe aktivitetet rreth tij. Kjo ndodh për shkak se për pjesën më të madhe të aktiviteteve nevojitet më shumë kohë, ndërsa kryetarët e komunave duan të arrijnë sa më shumë që është e mundur gjatë mandateve të tyre dhe të njëjtën gjë ta shfrytëzojnë gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e ardhshme lokale. Me fjalë tjera, ata rrallë vendosin për hapa të tillë duke, mënjeluar në këtë mënyrë përfundimin e

aktiviteteve me qëllim që të mos promovohet eventualisht nga një kryetar i ardhshëm komune.

Gjithashtu, komunat e këtij rajoni përballen edhe me probleme tashmë të njohura, si: numri i kufizuar i ekspertëve në këtë fushë dhe kapaciteti i dobët financiar për investime dhe aktivitete të efikasitetit energjetik. Për të përmirësuar këtë situatë, u kërkua që urgjentisht të krijohet një Fond për efikasitetin energjetik dhe ngritjen e vetëdijes publike për dobinë e masave nga efikasiteti energjetik.

Në aspektin e vetëdijes, një nga pjesëmarrësit në debat propozoi që fushatat dhe promovimet eventuale publike të përshtaten sipas nevojave të zonave rurale dhe urbane, duke pasur parasysh dallimet midis këtyre zonave në pikëpamje të potencialit dhe resurseve. Përforsimi i vetëdijes për efikasitetin energjetik në arsimin fillor dhe të mesëm ishte gjithashtu një pjesë e rekomandimeve, për çfarë organizatat joqeveritare lokale kanë shprehur dëshirën dhe gatishmërinë të përfshihen në mënyrë aktive, duke i ofruar kapacitetet dhe njohuritë e tyre.

Nga ana tjetër, nga sektori i biznesit u ankuan për procedurat e stërzgjatura administrative në lidhje me marrjen e lejeve të ndërtimit të kapaciteteve për energji të ripërtëritëshme, duke ilustruar se nevojiten 12 muaj për të marrë një leje ndërtimi për ndërtimin e mullinjve të erës. U përmend se kjo çështje i kthen investitorët e huaj. Për të eliminuar këtë pengesë, u propozua shënimi i zonave ndërtimore për ndërtimin e kapaciteteve të burimeve të ripërtëritshme të energjisë gjatë përgatitjes së planeve të detajuara urbanistike. Biznesmenët, gjithashtu, nënvizuan se drejtpërdrejt e ndiejnë fuqinë blerëse të qytetarëve, duke dhënë një shembull se shumica e qytetarëve nuk janë në gjendje të blejnë llamba kursimi (fluoreshente).

Si në rajonet e tjera, edhe në këtë rajon ka hapësirë për rritjen e bashkëpunimit midis kompanive dhe njësive të vetëqeverisjes lokale. Ata pajtohen se intensifikimi i PPP është një nga mënyrat për të. Një tjetër model për rritjen e bashkëpunimit është përfshirja e efikasitetit energjetik si një kriter në prokurimin publik. Dobia nga kjo do të ishte më e madhe - rritja e kursimit të energjisë dhe përforsimi i sektorit të biznesit në fushën e efikasitetit energjetik dhe përmirësimi i shërbimeve të tyre.

Përveç kësaj, komunat kanë nevojë për ndihmë rreth përgatitjes së specifikimeve për prokurimet publike që ato të jenë efektive dhe të realizueshme. U theksua edhe se bashkëpunimi i përgjithshëm dhe komunikimi ndërmjet komunave dhe kompanive duhet të jenë të

qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm, ndërsa gjithashtu u propozua edhe bashkëpunimi ndërkomunal, duke përfshirë edhe shkëmbimin e përforcuar të ideve, përvojave dhe pikëpamjeve lidhur me efikasitetin energjetik. Kjo që u tha ka një rëndësi të veçantë për ndriçimin rrugor, i cili i rëndon më shumë arkat komunale.

### 3.2.6 Rajoni i Vardarit

Mungesa e financave ishte një nga shqetësimet kryesore gjatë debatit në Veles sidhe problem me të cilin përballen komunat e Rajonit të Vardarit. Disa nga përfaqësuesit e komunave të këtij rajoni thanë se në buxhetet e tyre lokale nuk ka shkallë të veçantë që është e dedikuar për efikasitetin energjetik. Ashtu si në debatet e mëparshme, themelimi i Fondit të efikasitetit energjetik shihet si një mjet i rëndësishëm me të cilin dukshëm do të zbuten vështirësitë që lidhen me këtë problem.

Përveç kësaj, ata theksojnë se bllok-dotacionet nga ana e qeverisë qendrore duhet të mbeten në të njëjtin nivel, bile edhe në rastin e kursimeve si rezultat i masave të efikasitetit energjetik. Në të kundërtën, ata paralajmërojnë se hapat e tillë do të ishin dekurajues për autoritetet lokale në aspektin e aktiviteteve të ardhshme, rekonstruksioneve, renovimeve dhe adaptimeve në fushën e efikasitetit energjetik. Fondi për efikasitetin energjetik nuk u përmend si i vetmi burim për përmirësimin e përdorimit të qëndrueshëm të energjisë. Për këtë qëllim, si mjet u përmend edhe intensifikimi i PPP. Përfaqësuesit komunalë, si dhe biznesmenët që punojnë në fushën e efikasitetit energjetik arritën në konkluzion se nevojitet një përfshirje më e madhe e sektorit publik dhe privat për të ndryshuar pamjen ekzistuese në lidhje me PPP. U nënvizua se kjo është një mundësi veçanërisht e mirë që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ta përmirësojnë gjendjen e tyre financiare, ndërsa për komunat është një shans për të zvogëluar shpenzimet e energjisë.

Sa i përket kompanive, gjatë debatit u theksua se ekziston një potencial i madh për kompanitë ESCO, të cilat megjithatë duhet patjetër të demonstrojnë njohuritë multi-disiplinare lidhur me efikasitetin energjetik. Ndryshe, për investimet dhe aktivitetet e këtilla është thelbësore ekzistenca e një spektri të gjerë të ekspertëve të ndryshëm në fushën e arkitekturës, inxhinierisë elektrike, ndërtimtarisë dhe ekonomisë për të siguruar një dinamikë të mirë të aktiviteteve dhe më e rëndësishmja, që në

fund ai investim (aktivitet) të garantojë kursime.

Pjesëmarrësit e këtij debati rajonal gjithashtu pranuan se vetëdija në mesin e qytetarëve në lidhje me përfitimet e efikasitetit energjetik është ende në një nivel të pakënaqshëm. U theksua se ka ende hapësirë për përmirësimin e bashkëpunimit midis Agjencisë së Energjetikës dhe komunave. U tha se kjo mund të jetë veçanërisht e dobishme sidomos në pjesën e tërheqjes së investitorëve në fushën e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Megjithatë, për t'u rritur ritmi i investimeve, janë të domosdoshme ndryshimet administrative dhe adaptimet, siç janë shënimi i zonave të ndërtimit për kapacitetet e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. U theksua se ky veprim do të ishte një sinjal, si për investitorët vendas, ashtu edhe dhe për ata të huajt, se autoritetet lokale janë plotësisht të përkushtuar për efikasitetin energjetik dhe përdorimin e qëndrueshëm të energjisë dhe dëshirojnë investime të tilla. Pjesëmarrësit potencuan se sektori joqeveritar duhet patjetër të demonstrojë një përfshirje më të madhe në këtë fushë, e në këtë kontekst, IPA fondet janë një shans i shkëlqyeshëm. Kur është fjala për këto fonde, megjithatë, nevojitet një angazhim më i madh edhe nga ana e komunave.

Është interesante që mungesa e potencialit njerëzor nuk u përmendur si pengesë apo problem. Por, një fakt tjetër tregon që kjo nuk është ashtu. Gjegjësisht, Qendra maqedonase për efikasitet energjetik ka ndihmuar me përpunimin e planeve komunale për efikasitet energjetik në, thuajse, gjithë komunat nga ky rajon (përveç Velesit dhe Sveti Nikollës). Duke e pasur parasysh që ky problem është përmendur si një nga sfidat më të mëdha gjatë debateve tjera, ngelet dyshimi që edhe rajoni i Vardarit ballafaqohet me të njëjtin problem.

### 3.2.7 Rajoni i Pollogut

Edhe Rajoni i Pollogut ballafaqohet me pengesa kur është fjala për efikasitetin energjetik. Përveç mungesës së financave për aktivitete të këtilla, si një problem serioz ishte përmendur edhe mungesa e kapacitetit profesional.

*"Unë jam i vetmi që punoj në përpilimin e programit energjetik për komunën tonë. Unë jam i vetëdijshëm se ka kaluar afati për dorëzimin e tij, por ky është realiteti"* - tha një nga përfaqësuesit e komunave të këtij rajoni.

Rajoni i Pollogut, siç është përmendur tashmë në fillim, po lufton me problemin e financave. Kjo mungesë ndikon në intensitetin e investimeve, por njëkohësisht ndikon edhe mbi implementimin e programeve energjetike. Si një zgjidhje për këtë problem, si edhe në rajonet e tjera, u kërkua krijimi i Fondit të efikasitetit energjetik. Organizatat lokale joqeveritare propozuan që ai fond të ketë një strukturë të ngjashme si ish-Fondi i Mjedisit Jetësor në kuadër të Ministrisë së Ekologjisë. Si një urë për të tejkaluar problemin e financave u propozua një përfshirje më e madhe e Komisionit Rregullues në shpërndarjen e financave, si dhe një rritje eventuale e shumës së parave që transferohen nga buxheti qendror në llogaritë e komunave.

Një temë interesante ishte iniciuar nga përfaqësuesit e Komunës së Tetovës. Sipas mendimit të tyre, kryetarët e mëparshëm të kësaj komune nuk ishin tërësisht të përkushtuar dhe të interesuar për efikasitetin energjetik, gjë që nuk ndodh edhe me kryetaren aktuale të komunës. Këto pretendime implikojnë për mungesën e vullnetit politik në të kaluarën dhe të vendosmërisë për efikasitetin energjetik - një parakusht për shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe efikas të energjisë në nivel lokal.

Përfaqësuesit e komunës u ankuan edhe për koordinimin dhe bashkëpunimin e dobët midis institucioneve të qeverisë në lidhje me dhënien e dokumenteve - një problem që sipas tyre ndikon mbi ata investitorë që duan të investojnë në kapacitetet e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Nga komuniteti i biznesit dhe nga komunat unanimitisht u konfirmua se ekziston një potencial i madh i PPP, veçanërisht në pjesën e ndriçimit rrugor. Por, si një pengesë për këtë paraqitet mosbesimi ndaj kompanive në aspektin e pagesës së obligimeve nga ana e komunave, duke pasur parasysh borxhet e tyre dhe sfidat financiare, e kjo gjendje i bën firmat skeptike të lidhin këto lloje marrëveshesh.

U kërkua një bashkëpunim i mëtejshëm midis të gjitha palëve të përfshira, duke përfshirë Qendrën Rajonale për Zhvillim, si dhe forcimin e angazhimit të rrjetit të efikasitetit energjetik në kuadër të BNJVL-së. Edhe pse u tha se në këtë rajon ekziston ndërgjegjësimi i publikut për përfitimet e efikasitetit energjetik, megjithatë nuk do të jenë të kota aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit të mëtejshëm.

### 3.2.8 Rajoni verilindor

Ky debat ishte i fundit në serinë e debateve, por kontribui për pikëpamje tërësisht të ndryshme. Kuptohet, mungesa e financave në buxhetet komunale është identifikuar si sfida më e madhe. Përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes lokale thanë se themelimi i Fondit të efikasitetit energjetik do të kontribuojë për rritjen e intensitetit të aktiviteteve të këtilla. Ata shtuan edhe se është e preferueshme që ky fond të ofrojë grante, por duke e ditur se kjo është pak e realizueshme, propozuan që fondi të ofrojë huazime (kredi) me një normë të ulëta interesi dhe një periudhë të gjatë të kthimit.

Disa prej tyre, sidomos ato të komunave më të vogla, theksuan edhe problemin e mungesës së kapaciteteve njerëzore (profesionale) që plotësisht ndikojnë mbi planifikimin e aktiviteteve të lidhura me efikasitetin energjetik. Diskutuesit theksuan se formimi i ekipeve të përbashkëta administrative me përfaqësues nga çdo komunë e Rajonit verilindor (si ai ekip i Rajonit të Vardarit) është një zgjidhje e mundshme për këtë problem dhe shtuan se ky organ do të paraqesë një katalizator për një bashkëpunim më intensiv.

Megjithatë, përfaqësuesit e sektorit të biznesit prekën disa tema interesante. Në fakt, ekzistenca e konkurrencës joligjore (shitja pa certifikata) ndikon mbi ato firma që veprojnë sipas ligjit. Nga aspekti i bashkëpunimit me komunat, disa nga biznesmenët thanë se përkundër procedurave të stërzgjjatura administrative për prokurimet publike, një problem paraqet edhe pagesa e vonuar e obligimeve. Sipas tyre, kjo veçanërisht ndikon mbi firmat më të vogla që nuk mund të përballojnë barrën financiare. Lidhur me prokurimet publike, nga komunat thanë se kostoja ende luan një rol kryesor dhe theksuan se në qoftë se ka dëshirë për përfshirjen e efikasitetit energjetik si kriter në tenderët, është e domosdoshme që të bëhen ndryshime ligjore.

Përfaqësuesit e komunës së Kumanovës thanë se PPP është shumë i dobishëm, por edhe potencuan se kompanitë që punojnë në fushën e efikasitetit energjetik do të mund të tregonin një përgjegjësi më të madhe shoqërore me rikonstrukcionin e një pjese të ndërtesave publike, për të cilat rikonstrukcione shpenzimet do t'i mbulojnë vetë. Kjo mund të kompensohet nga këshillat komunalë përmes dhënies së hapësirës pa pagesë për reklama.

Lidhur me bashkëpunimin, u tha se komunat duhet të forcojnë

komunikimin me organizatat joqeveritare, ndërsa u kërkua edhe një përfshirje më e madhe nga ana e rrjetit të efikasitetit energjetik, në kuadër të BNJVL-së, sidomos në pjesën e bashkëpunimit ndërkomunal. Megjithatë, përfaqësuesit e komunave treguan edhe një dozë të vetëkritikës. Pranuan se janë të nevojshme përpjekjet shtesë në drejtim të monitorimit të konsumit të energjisë në sektorin publik dhe shënimin e saj më të saktë për secilën ndërtesë veç e veç.

**3.3 Tabela e problemeve dhe e zgjidhjeve**

| Rajoni                   | Pengesat ligjore dhe rregullatore                                                                                                                                                                                           | Sfidat institucionale dhe administrative                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Kapaciteti financiar                                                                                                                                                                               | Kapaciteti profesional/i ekspertëve                                                                      | Bashkëpunimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Vetëdija                                                                                                                     | Vërejtjet shtesë                                                                                                                                                                                 |
|--------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Rajoni i Shkupit</b>  | <b>K:</b> Mungesa e një ligji të veçantë të efikasitetit energjetik; nevoja e themelimit të Fondit të efikasitetit energjetik; <b>B:</b> Lehtësime tatimore për importin e pajisjeve të ndërtimit me efikasitet energjetik; | <b>K:</b> Shënim i zonave ndërtimore për investime nga fusha e efikasitetit energjetik dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë që në periudhën e hartimit të Planeve të detajuara urbanistike;                                                                                                                                                                                                                                                                             | <b>K:</b> Mungesa e mjeteve financiare për investime dhe implementim të programeve dhe projekteve;                                                                                                 | <b>B:</b> Numri i kufizuar i punëtorëve ndërtimorë për aktivitetet e lidhura me efikasitetin energjetik; | <b>K/B:</b> Numri modest i kontratave të partneritetit publik - privat;                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                              | <b>K:</b> Intensifikimi i procesit të gazifikimit; <b>K/B:</b> organizimi dhe pjesëmarrja në panairt vendase dhe ndërkombëtare për efikasitet energjetik; Tryeza më të shpeshta të rrumbullakta; |
| <b>Rajoni i Pollogut</b> | <b>K/O:</b> Nevoja e themelimit të Fondit të efikasitetit energjetik, të cilin do ta kenë në dispozicion edhe organizatat joqeveritare;                                                                                     | <b>K/B:</b> Komunitat dhe kompanitë ballafaqohen me problemin e mungesës së koordinimit ndërmjet institucioneve qeveritare në drejtim të dhënies së dokumentacionit të ndërtimit; nevoja e përfortimit të partneritetit publik-privat, sidomos në pjesën e ndërtimit rrugor; <b>O:</b> Thjeshtësimi i procedurave administrative për të investuar në burimet e ripërtëritshme të energjisë; <b>B:</b> Kompanitë ballafaqohen me konkurrencën jolojale (shitje pa certifikatë); | <b>K:</b> Mungesa e mjeteve financiare dhe aktivitetet që lidhen me efikasitetin energjetik; <b>K:</b> Bartjet shtesë eventuale nga Komisioni Rregullator për Energjetikë për buxhetet e komunave; | <b>K:</b> Kapaciteti i dobët profesional;                                                                | <b>K:</b> Gjendja e keqe financiare shkakton mosbesim të kompanitë lokale për partneritetin publik - privat os e një tjetër lloj më e madhe e rrjetit të bashkëpunimi; pjesëmarrja BNJVL-së në bashkëpunimin ndërkomunal; përfortimi i Zhvillimit në kuadër të efikasitetit energjetik; <b>K/B/O:</b> Intensifikimi i bashkëpunimit të përbashkët dhe rajonal; | <b>K:</b> Shembujt nga e kaluara kur kryetarët e komunave nuk kanë qenë tërësisht të përkushtuar për efikasitetin energjetik |                                                                                                                                                                                                  |

|                     |                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                   |                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                             |
|---------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Rajoni veritilindor | K: Nevoja e themelimit të Fondit të efikasitetit energjetik; mungesa e normave ligjore për përfshirjen e efikasitetit energjetik si një kriter gjatë prokurimit publik (çmimi ende e luan rolin kryesor); | K: Thjeshtësimi i procedurave administrative për të investuar në burimet e ripërtëritshme të energjisë; monitorimi i tërësisë së konsumit të energjisë në ndërtesat publike;<br><b>K/B:</b> Nevoja e intensifikimit të partneritetit publik - privat në pjesën e mbeturinave dhe ndriçimit rrugor; | K: Mungesa e mjeteve financiare për investime dhe aktivitete që lidhen me efikasitetin energjetik;<br><b>O:</b> Burimet e pakufizuara financiare; | K: Kapaciteti i dobët profesional, sidomos te komunat më të vogla;                                                 | K: Pjesëmarrja më e madhe e rrjetit të efikasitetit energjetik pranë BNUVL - së në bashkëpunimin ndërkomunal; përf forcimi i rolit të Qendrës Rajonale të Zhvillimit në drejtim të efikasitetit energjetik<br><b>K/O:</b> Bashkëpunimi i pamjaftueshëm;                                                                                                                                                               | K: Pjesëmarrja më e madhe e rrjetit të efikasitetit energjetik pranë BNUVL - së në bashkëpunimin ndërkomunal; përf forcimi i rolit të Qendrës Rajonale të Zhvillimit në drejtim të efikasitetit energjetik<br><b>K/O:</b> Bashkëpunimi i pamjaftueshëm; | Nevoja e përgjegjësisë më të madhe shoqërore të sektorit të biznesit në lidhje me efikasitetin energjetik (rikonstruksioni i një pjese të objekteve publike në logaritë e tyre që do të kompensonte me një hapësirë pa pagesë për reklamim) |
| Rajoni juglindor    | K: Themelimi i fondit të efikasitetit energjetik;                                                                                                                                                         | <b>B:</b> Procedura komplekse rreth investimeve të lidhura me efikasitetin energjetik;<br><b>O:</b> Vështirësitë në sigurimin e një garancie bankare për aplikimin e thirrjeve të projekteve; procedura e gjatë dhe komplekse në mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm të aplikimit;            | K: Mungesa e mjeteve financiare për investime dhe aktivitete që lidhen me efikasitetin energjetik;<br><b>O:</b> Burimet e pakufizuara financiare; | K: Kapaciteti i dobët profesional;<br><b>O:</b> Mungesa e ndihmës së ekspertëve në fazën e hartimit të projekteve; | K: Transparenca më e madhe për bashkëpunim me organizatat joqeveritare; shfrytëzimi i rrjetit të efikasitetit energjetik pranë BNUVL - së për këmbimin e ideve, propozimeve dhe pikëpamjeve;<br><b>K/B:</b> Rritja e kontratave të partneritetit publik - privat, sidomos në pjesën e ndriçimit rrugor;<br><b>O/B:</b> Intensifikimi i partneritetit ndërmjet organizatave joqeveritare dhe komunitetit të bizneseve; | Mungesa e vetëdijes te qytetarët për përfitimet e politikave/ investive për efikasitetin energjetik; përfshirja me e madhe e efikasitetit energjetik në arsimin filior dhe të mesëm;                                                                    | <b>K/O/B:</b> Qasja shumë e madhe deri te informatat për mekanizmat dhe mjetet e reja të efikasitetit energjetik;<br><b>K/B:</b> Intensifikimi i ndërtimit të hidrocentraleve të vogla;                                                     |

|                      |                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                      |
|----------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|
| Rajoni i Pellagonisë | K: Themelimi i fondit të efikasitetit energjetik; | K: Procedurat e gjata administrative lidhur me lejet e ndërtimit (p.sh. - procedura administrative për marrjen e lejes ndërtimore për mullirin e ajrit është 12 muaj); nevoja e përfshirjes së efikasitetit energjetik si një kriter gjatë prokurimit publik; interesi afatshkurter i kryetarëve të komunave për investime dhe masa që lidhen me efikasitetin energjetik; shënim i zonave ndërtimore për investime të fushës së efikasitetit energjetik dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë që në periudhën e hartimit të Planeve të detajuara urbanistike; | K: Fuqia modeste financiare për investime që lidhen me efikasitetin energjetik;<br><b>B:</b> Sektori i bizneseve ndien fuqinë blerëse të qytetarëve; (p.sh. qytetarët nuk kanë mjaft mjete financiare për të blerë poçe (drta) që kursejnë);                                                                                                                                        | K: Potencial i modest profesional i ekspertëve;  | <b>K/B:</b> Nevoja e intensifikimit të partneritetit publik - privat;<br><b>K:</b> Mungesa e shkëmbimit të përvojave dhe ideve në pjesën e ndriçimit rrugor; nevoja e formimit të ekipeve të përbashkëta të efikasitetit energjetik;<br><b>O:</b> Përgatitja për të ndihmuar në sferën e efikasitetit energjetik;                                                                                                                                                                                                                                                                     | Mungesa e vetëdijes te qytetarët për përfitimet e politikave/ investive për efikasitetin energjetik; Nevoja e fushatave në përputhje me nevojat e mjediseve urbane dhe rurale; përforcimi i efikasitetit energjetik në arsimin formal dhe joformal; | Potenciali i shfrytëzimit të fondet e ndërkombëtare; |
| Rajoni i Vardarit    | K: Themelimi i fondit të efikasitetit energjetik; | K: Përfshirja e efikasitetit energjetik dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë si parakushte për marrjen e lejes së ndërtimit; shënim i zonave të ndërtimit për investime në fushën e efikasitetit energjetik dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë që në periudhën e hartimit të Planeve të detajuara urbanistike; sfidat në sferën e regjistrimit të ndërtesave publike;                                                                                                                                                                               | K: Resurset e kufizuara financiare; kërkesa e shumë konstante të bllok - transaksioneve të buxhetit qendror edhe në kushte të kursimit; përpjekje shitesë për shfrytëzimin e IPA fondeve për efikasitetin energjetik; Pjesëmarrja më e ; madhe e sektorit qeveritar në sigurimin e mbështetjes financiare për projektet lokale, sidomos për IPA fondet e bashkëpunimit ndërkufitar; | K: Potenciali i modest profesional i ekspertëve; | <b>K/B:</b> Intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe kompanive në drejtim të efikasitetit energjetik, sidomos midis ESCO kompanive;<br><b>K:</b> Përforcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me Agjencinë e Energjetikës së RM - së në drejtim të gjetjes së investitorëve potencialë (me paralajmërim paraprak ndaj Agjencisë së komunat përkatëse i kanë vërejtur zonat ndërtimore për ndërtimin e stacioneve të burimeve të ripërtëritshme të energjisë);<br><b>B:</b> Pjesëmarrja me e madhe e komunitetit të bizneseve lidhur me investimet e efikasitetit energjetik, | Animimi i qytetarëve lokalë për përfitimet e efikasitetit energjetik dhe përforcimi i kontributit të tyre lokal në avancimin e tij;                                                                                                                 |                                                      |



|                         |                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                         |
|-------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Rajoni lindor</b>    | <b>K:</b> Mungesa e një ligji të veçantë të efikasitetit energjetik, i cili do ta thjeshtësojë dhe përforcojë procedurën e investimit; nevoja e themelimit të Fondit të efikasitetit energjetik; | <b>K:</b> Problemet dhe vështirësitë në sigurimin e garancive bankare që nevojiten për të lidhur kontrata të partneritetit publik - privat; labirintet ligjorë gjatë përpunimit të kontratës së partneritetit publik - privat (përshtatja e kontratës me shumë ligje);                                                                                     | <b>K:</b> Mungesa e mjeteve financiare për investime në sferën e efikasitetit energjetik që reflektohen edhe mbi përpilimin e studimeve të fizibilitetit; nevoja e një fondi të veçantë, i cili do t'u dedikohet amvisërive, fasadat e të cilave nuk janë të përfunduara; lehtësimi i qasjes deri te kreditë; <b>K/O:</b> Burimet e kufizuara financiare; | <b>K:</b> Mungesa e ekspertëve nga sfera e efikasitetit energjetik;  | <b>K/O:</b> Nevoja e transparencës dhe e dëshirës së bashkëpunimit; <b>B:</b> Potenciali për investim në bio - masë dhe ujërat termale;                                                                                                                            | Veçdija e pamjaftueshme në mesë të qytetarëve për përfitimet e efikasitetit energjetik; nevoja e ngritjes së vetëdijes dhe për gjetësinë për shfrytëzimin e qëndrueshëm të energjisë në procesin e arsimi, si dhe përmes fushatave të gjera publike; demonstrimi i vendosmërisë së fortë dhe të qartë nga ana e politikëbërësve, si parakusht për avancimin e efikasitetit energjetik; | <b>K:</b> Intensifikimi i procesit të gazifikimit dhe sigurimi i një baze ligjore që komunat të mund të përfshihen në zhvillimin e përmirësimit të rrjetit transmetues; |
| <b>Rajoni juglindor</b> | <b>K:</b> Miratimi i rregulloreve që do të saktësojnë dispozitat që lidhen me efikasitetin energjetik; nevoja e themelimit të Fondit të efikasitetit energjetik;                                 | <b>K:</b> Procedurat e gjata për hartimin e Planeve të detajuara urbanistike lidhur me burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe efikasitetit të saj; zyra të disperzuara të Agjencisë së Energjetikës së RM-së në vetë komunat, me qëllim që të përforcohet bashkëpunimi i ndërsjellë; <b>B:</b> Problemet me EVN-në lidhur me lejen e kyçjes së rrjetit; | <b>K:</b> Mungesa e mjeteve financiare;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | <b>K:</b> Mungesa e ekspertëve të sferës së efikasitetit energjetik; | <b>K/B:</b> Intensifikimi i partneritetit publik-privat; <b>B:</b> Angazhimi shtesë për investim në bio-masën si energjens në mjediset rurale; <b>O:</b> Intensifikimi i bashkëpunimit me komunat mbi aplikimin e projekteve që lidhen me efikasitetin energjetik; | Ngritje e vetëdijes ndërmjet komunave mbi bashkëpunimin me sektorin joqeveritar; joqeveritar; gjetja e mënyrave të bashkëpunimit ndërkomunal; nevoja për fushata në arsim dhe shoqëri për ngritjen e vetëdijes publike;                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                         |

**Legjendë për tabelën:** **K** – Komuna; **B** – Sektor i biznesit; **O** – Organizata joqeveritare

## 4 Rekomandimet përfundimtare

Duke marrë parasysh të gjitha gjërat që janë përmendur në tre kapitujt dhe në bazë të analizës së situatës aktuale në Republikën e Maqedonisë, të tre autorët e këtij dokumenti kanë përgatitur rekomandime për komunat që do të duhej të ndihmonin në kapërcimin e problemeve ekzistuese, mënjanimin e pengesave dhe mungesave dhe do të mundësonin avancimin e efikasitetit energjetik në nivel lokal:

- Themelimi i Fondit të efikasitetit energjetik duhet të jetë një nga prioritetet më të rëndësishme, sepse qasja deri te mjetet financiare është problemi më i rëndësishëm dhe pengesa kryesore për të gjitha institucionet publike. Mungesa e një fondi të tillë është përmendur gjatë të tetë debateve rajonale në Republikën e Maqedonisë. Fondi i tillë mund të organizohet si një fond i ripërtëritjes, i cili do të mbushet nga buxheti i shtetit, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare, detyrimet e ndotësve etj. Grante apo kredi me norma të ulëta interesi janë mekanizmat e mundshëm për të mbështetur përmirësimin e efikasitetit energjetik në institucionet shtetërore;

- Mungesa e njohurive profesionale dhe të ekspertizës, shkëmbimi i dobët dhe i rrallë i informatave ndërmjet komunave, padituria se komunat kanë instrumente financiare në dispozicion, përvoja modeste me kompanitë ESCO janë vetëm një pjesë e problemeve ekzistuese. Rritja e nivelit të dijes dhe përforcimi i shkëmbimit të informatave, si dhe përforcimi i bashkëpunimit ndër-komunal mund të arrihet përmes seminareve të ndryshme, punëtorive, trajnimeve etj.;

- Një tjetër mënyrë për të përmirësuar komunikimin, bashkëpunimin dhe këmbimin e njohurive dhe shembujve të praktikave më të mira është aplikimi i një platforme të komunikimit elektronik, si një mjet që ofron këmbimin e lirë dhe të shpejtë të informatave.

- Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar / rajonal midis zyrtarëve komunalë dhe pjesëmarrja në aktivitetet e asociacioneve kombëtare / rajonale komunale. (Duke pasur parasysh se gjuha angleze apo ndonjë gjuhë tjetër e huaj mund të jetë një pengesë për zyrtarët shtetërorë (komunalë), theksi duhet të vihet në bashkëpunimin me vendet me gjuhë të ngjashme);

- Një nga prioritetet më të rëndësishme për të gjitha komunat është aplikimi i një Sistemi të plotë për menaxhimin e energjisë (SME) në nivel komunal. Sistemet e tilla mund të luajnë një rol të rëndësishëm në

fazën fillestare (SME-ja kontribuon për harxhime të vogla shtesë, por, nëse zbatohet siç duhet, mund të gjenerojë kursime deri në 15%). Kursimet fillestare në fazën që vijon zakonisht gjenerojnë investimet për masat e mëtejshme të efikasitetit energjetik;

- Pjesa e rëndësishme e një Sistemi të menaxhimit të energjisë, që është mirë i zhvilluar është pasja e një sistemi komunal informativ për konsumin e energjisë, i cili mundëson monitorimin e konsumit, kontrollimin e faturave të energjisë dhe analizën e tipit, strukturën, tendencat dhe konsumet e energjisë së harxhuar. (Sistemi informativ i komunës Bar të Malit të Zi mund të shërbejë si një shembull i mirë

- Mungesa e resurseve njerëzore dhe detyrimeve të qarta mbi menaxhimin e energjisë si një obligim primar (ose i vetëm), është një problem me të cilin komunat ballafaqohen shumë shpesh. Sipas kësaj, rrija e kapaciteteve në nivel komunal (punësimi i personave të kualifikuar dhe të përkushtuar), që janë përgjegjës për menaxhimin e energjisë, do të kontribuojë për përfitime dhe kursim të energjisë.

- Në mënyrë që të motivohen të punësuarit përkatës në komunat, organet shtetërore, Ministria e Ekonomisë ose Agjencia e Energjetikës mund të organizojnë gara dhe një sistem shpërblimi për komunat më të avancuara dhe menaxherët komunalë. Mjetet e nevojshme për këtë do të siguroheshin nga buxheti i shtetit apo Fondi i efikasitetit energjetik.

- Formimi i sistemit informativ për ndriçim publik. Avancimi i funksionalitetit të tij, mirëmbajtja dhe kontrolli i sistemit të tillë është një nga mënyrat e lira dhe efektive për të arritur kursime të larta të energjisë për një periudhë të shkurtër kohore.

- Monitorimi i rrjetit të furnizimit me ujë dhe rrjeti i ujërave të zeza në komuna. (Analizat e aktiviteteve, përmirësimi i mirëmbajtjes, monitorimi i konsumit dhe i harxhimeve, mundësitë e instalimit të motorëve me shpejtësi të ndryshueshme dhe bateri për kompensimin e energjisë reaktive).

- Përgatitja dhe zbatimi i planeve afat-mesme komunale (programet trevjeçare energjetike dhe planet vjetore për efikasitet energjetik) në përputhje me PAKEE. Dokumentet e këtyre kontribuojnë për harmonizimin e politikave që lidhen me efikasitetin energjetik në nivel shtetëror dhe lokal dhe shërbejnë si një udhërrëfyes për aktivitetet e duhura me qëllim të sigurimit të komunave energjetike-efikase.

- Në përputhje me dispozitat e direktivave dhe legjisllacionin

vendor (Ligji i Energjetikës, Ligji për ndërtim dhe rregulloret përkatëse), komunat duhet të zbatojnë kontrollet energjetike të ndërtesave publike nën qeverisjen e tyre (me të cilat udhëhiqen). Gjithashtu, të gjitha sistemet e ngrohjes dhe klimatizimit duhet të kontrollohen rregullisht. Ndërtesat me një sipërfaqe të shfrytëzimit prej mbi 500m<sup>2</sup> duhet të jenë të certifikuara, kurse certifikatat e karakteristikave energjetike duhet të publikohen në mënyrë përkatëse në një vend ku mund të bien ne sy. Të gjitha këto aktivitete duhet të jenë një pjesë përbërëse e sistemit të menaxhimit të energjisë (SME).

- Rinovimi i ndërtesave publike. (Sipas nivelit ekonomikisht më fitimprurës dhe duke ndjekur karakteristikat minimale energjetike të ndërtesave që janë definuar në legjisllacionin vendor);

- Zbatimi i kërkesave të menaxhimit të energjisë dhe certifikimi sipas Standardit ndërkombëtar për menaxhimin energjetik - ISO 50001;

- Aplikimi i skemave dhe udhëzuesve për përfshirjen e efikasitetit energjetik si një kriter në prokurimin publik;

- Themelimi i tregut për ESCO kompanitë përmes aktiviteteve për zhvillimin e tregut dhe fushatave informative.

- Pjesëmarrja në nismat ndërkombëtare që synojnë mbështetjen e komunave (Konvencioni i kryetarëve të komunave, java evropiane e lëvizshmërisë, "Qytetet e zgjuara")

- Trajnimet dhe seminarët për përmirësimin e kapaciteteve për përgatitjen e aplikimeve të projekteve të financuara nga BE apo fonde të tjera. Zgjerimi i njohurive dhe informatave mbi thirrjet e hapura për aplikime.

## Bibliografi:

**(1)** DIRECTIVE 2006/32/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 05 April 2006 on energy end-use efficiency and energy services and repealing Council Directive 93/76/EEC, Official Journal of the European Union L114, 27.04.2006 Pages 0064-0085;

**(2)** DIRECTIVE 2009/125/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 21 October 2009 establishing a framework for the setting of ecodesign requirements for energy-related products, Official Journal of the European Union L285, 31.10.2009 Pages 0010-0035;

**(3)** DIRECTIVE 2010/30/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 19 May 2010 on the indication by labelling and standard product information of the consumption of energy and other resources by energy-related products, Official Journal of the European Union L153, 18.06.2010 Pages 0001-0011;

**(4)** DIRECTIVE 2010/31/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 19 May 2010 on the energy performance of buildings, Official Journal of the European Union L 153, 18.06.2010 Pages 0013-0035;

**(5)** DIRECTIVE 2012/27/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 25 October 2012 on energy efficiency, amending Directives 2009/125/EC and 2010/30/EU and repealing Directives 2004/8/EC and 2006/32/EC, Official Journal of the European Union L 315, 14.11.2012 Pages 0001-0056;

**(6)** COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE COUNCIL, THE EUROPEAN PARLIAMENT, THE ECONOMIC AND SOCIAL COMMITTEE AND THE COMMITTEE OF THE REGIONS, Action Plan to Improve Energy Efficiency in the European Community, COM(2000)247 final, Brussels, 26.04.2000;

**(7)** COMMUNICATION FROM THE COMMISSION, Action Plan for Energy Efficiency: Realising the Potential, COM(2006)545 final, Brussels, 19.10.2006;

**(8)** COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT, THE COUNCIL, THE EUROPEAN ECONOMIC AND SOCIAL COMMITTEE AND THE COMMITTEE OF THE REGIONS, Energy Efficiency Plan 2011, COM(2011)109 final, Brussels, 8.3.2011;

**(9)** GREEN PAPER Towards a European strategy for the security of energy supply, COM(2000)769 final, Brussels, 29.11.2000;

**(10)** COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT, THE COUNCIL, THE EUROPEAN ECONOMIC AND SOCIAL COMMITTEE AND THE COMMITTEE OF THE REGIONS, Energy 2020 - A strategy for competitive, sustainable and secure energy, COM(2010) 639 final, Brussels, 10.11.2010;

**(11)** European Commission / Energy Efficiency – web presentation [http://ec.europa.eu/energy/efficiency/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/energy/efficiency/index_en.htm)

**(12)** European Union law – web presentation <http://eur-lex.europa.eu/>

**(13)** Presentation at the Workshop on Financing Options for National EE action Plans, Skopje, 8 October, 2013

**(14)** Стратегија за развој на енергетиката на Република Македонија до 2030 година (Службен Весник на Република Македонија бр.61/10);

**(15)** Стратегијата за искористување на обновливите извори на енергија во Република Македонија до 2020 година (Службен Весник на Република Македонија бр. 125/10);

**(16)** Стратегијата за унапредување на енергетската ефикасност во Република Македонија до 2020 година (Службен Весник на Република Македонија бр. 143/10);

**(17)** Прв Акционен план за енергетска ефикасност на Република Македонија до 2018 година (донесен на седница на Владата на РМ на 05.04.2011);

**(18)** Програма за реализација на Стратегијата за развој на енергетиката на Република Македонија за периодот од 2013 до 2017 година.

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352:351.824.11(497.7)

MARKOVSKA, Natasha

Nxitje e efikasitetit energjetik : si mund të ndihmojnë komunitet lokale? / [autorë Natasha Markovska, Zlatko Simonovski, Radovan Nikceviç ; përkthyer nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Slave Çorbev. - Shkup : Konrad Adenauer : Shoqëria gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar : Qendra për hulumtime dhe krijimin e politikave, 2013. - 47 str. : граф. прикази ; 30 см

Библиографија: стр. 46-47

1. Simonovski, Zlatko [автор] 2. Nikceviç, Radovan [автор]

а) Локална самоуправа - Политика за енергетска ефикасност -  
Македонија  
COBISS.MK-ID 95041034